

RAPORT 2019

Monitorimi i Strategjisë Sektoriale të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) në lidhje me efektivitetin e Masave Aktive të Tregut të Punës (MATP-ve) për punësimin e pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian

Vebi Mujku

QERSHOR, 2019

Raporti

Monitorimi i Strategjisë Sektoriale të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) në lidhje me efektivitetin e Masave Aktive të Tregut të Punës (MATP-ve) për punësimin e pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian

The views expressed in this assessment do not necessarily reflect the views of the Regional Cooperation Council or of its participants, nor of the European Union and the Open Society Foundations."

Përmbajtja:

Lista e shkurtesave	5
Hyrje	6
Përmbledhje ekzekutive	6
Masat aktive të tregut të punës	8
Të gjeturat kryesore nga monitorimi i Strategjisë	9
Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës	9
Zyra e punësimit - Fushë Kosovë	13
Komuna e Fushë Kosovës	13
QPS Fushë Kosovë	14
Zyra për komunitete dhe kthim - Fushë Kosovë	15
Zyra e punësimit - Obiliq	16
Komuna e Obiliqit	16
Masa aktive	17
Qendra për punë sociale - Obiliq	18
Zyra për komunitete dhe kthim - Obiliq	19
Qendra e aftësimin profesional – Prishtinë (Fushë Kosovë dhe Obiliq)	20
Zyra e punësimit - Gjakovë	22
Komuna e Gjakovës	22
Qendra për punë sociale - Gjakovë	23
Zyra e punësimit Prizren	25
Komuna e Prizrenit	25
Qendra për punë sociale - Prizren	27
Qendra për punë sociale - Prizren	28
Qendra për punë sociale - Prizren	29
OJQ-ja lokale “Romani Avazo”	30
Rekomandime:	31
THIRRJE PËR APLIKIM PROGRAMI PËR SUBVENCIONIMIN E PAGËS	33

Lista e shkurtesave

APRK – Agjencia e Punësimit i Republikës së Kosovës

DPP - Departamenti i Punës dhe Punësimit

MAPT - Masat Aktive të Tregut të Punës

MPMS - Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale

MASHT - Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë

PNP - Praktika në punë

QAP - Qendra e aftësimit profesional

QPS - Qendra për punë sociale

OJQ - Organizata joqeveritare

SPP - Subvencioni për pagë

SAS – Skema e asistencës sociale

TNP – Trajnimi në punë

ZKK - Zyra për kthim dhe komunitete

ZP - Zyra e punësimit

Hyrje

Përmbledhje ekzekutive

Ky raport ofron një përmbledhje të monitorimit të strategjisë sektoriale të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale në lidhje me efektivitetin e masave aktive të tregut të punës për punësimin e pjesëtarëve të komuniteteve rome, ashkali dhe egjiptiane në katër komuna.

Raporti është realizuar gjatë muajve maj e qershor të vitit 2019 ku janë përfshi katër komuna sipas mostrës së numrit të popullatës me më shumë minoritete: Gjakova, Prizreni, Fushë Kosova dhe Obiliqi dhe janë marrë për bazë të dhënat e vitit 2018 si dhe aty ku ka pasur mundësi edhe për tre muajt e parë të vitit 2019 si dhe është përqendruar në fushat e veprimit të cilat adresohen në Strategjinë Sektoriale të MPMS-së, strategjive komunale dhe planit të veprimit nëpër komunat Fushë Kosovë, Obiliqi, Gjakovë dhe Prizren. Për realizimin e këtij raporti është analizuar "Strategjia sektoriale 2018-2012"¹ dhe "Strategjia për përfshirjen e komuniteteve rome dhe ashkali në shoqërinë kosovare 2017-2021",² "Përfshirja sociale e grupeve të marginalizuara në Komunën e Prizrenit", "Plani lokal i veprimit për përfshirjen e komuniteteve rome, ashkali dhe egjiptiane të Komunës së Prizrenit 2019-2013", "Ligji kundër diskriminimit", "Ligji për përdorimin e gjuhëve" etj. si dhe pjesa praktike e punës për zhvillimin e raportit ku është analizuar gjendja aktuale e komuniteteve rome, ashkali dhe egjiptiane në terren si dhe zotimet e Qeverisë së Kosovës kundrejt realizimit të objektivave për zbatimin e MATP-ve.

Të gjeturat e këtij raporti tregojnë se zbatimi i Strategjisë sektoriale përballet me shumë vështirësi dhe nuk janë afër përmbushjes së aktiviteteve të përcaktuara, kryesisht për shkak të mungesës së angazhimit politik, burimeve të pamjaftueshme financiare dhe njerëzore për monitorimin e progresit, koordinimit jo të mirë të institucioneve në nivel qendror dhe lokal si dhe, në anën tjetër, për shkak të kapaciteteve të kufizuara të komuniteteve rome, ashkali dhe egjiptiane në përgatitje shkollore, shkrim-lexim, gatishmëri për angazhim në punë, lidhja e ngushtë me familjen dhe mosgatishmëria e largimit nga rrethi ku jeton, varësia e madhe nga skema e asistencës sociale.

Sa i përket Agjencisë së punësimit në kuadër të MPMS-së, si institucion përgjegjës i ngarkuar me zbatimin dhe monitorimin e Strategjisë, shihet se nuk ka kapacitete të mjaftueshme njerëzore e financiare për të përmbushur në mënyrë efektive mandatin e saj. Kjo mungesë e kapaciteteve ka ndikuar negativisht në koordinimin institucional dhe vendosjen e një sistemi të rregullt institucional për monitorim dhe raportim të zbatimit të Strategjisë sektoriale në nivel qendror e lokal. Fuqizimi i komuniteteve nga Agjencia e punësimit dhe Zyra e punësimit për komunitetet është e bazuar kryesisht në mbështetjen e organizatave joqeveritare, qoftë vendore apo ndërkombëtare, por edhe organizatave qeveritare, në mungesë të stafit adekuat që të merret më komunitetet në gjuhën e tyre, që shpesh paraqitet edhe si pengesë.

1. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale

2. Zyra e Kryeministrit

Për realizimin e raportit janë përgatitur pyetësorët ku përmes intervistave gjysmë të strukturuar janë intervistuar të gjithë akterët shtetërorë dhe joshetërorë në nivele komunale, me qëllim të mbledhjes së të dhënave sa më të sakta dhe burimore nga zbatuesit e politikave në nivel komunal.

Në anën tjetër, jo të gjitha komunat kanë krijuar plane të veprimit për përmbushjen e strategjisë sektoriale të MPMS-së. Edhe në ato Komuna të cilat kanë krijuar plane të veprimit, nuk janë krijuar kushtet dhe ndarë mjetet financiare për përmbushjen e planit të veprimit. Kjo është përcjellë edhe me mungesë të kapaciteteve profesionale dhe vullnetit politik i cili ka ndikuar drejtpërdrejtë që zbatimi i planit të mos jetë i një niveli të kënaqshëm.

Po ashtu duhet të përmendet se përpilimi i këtij raporti është bërë në një periudhë kohore kur një numër i madh i të rinjve nga Kosova, përfshi edhe të rinjtë e komuniteteve, po largohen drejt vendeve tjera për të kërkuar punë dhe jetë më me dinjitet në njërin anë, kurse në anën tjetër bizneset dhe kompanitë janë në kërkim të punëtorëve, sidomos atyre që janë me ndonjë zanat apo profesion - duke mos përjashtuar as punëtorët fizik pa përgatitje shkollore, por të aftë për punë. Padyshim se është

shumë i theksuar ndryshimi mes ofertës dhe kërkesës në tregun e punës, ku vetëm brenda vitit 2018 dhe periudhën e parë të vitit 2019 numri i bizneseve t'i vërejë mungesat e punëtorëve dhe të interesohet shumë më tepër se përpara për angazhim të punëtorëve, duke mos përzgjedh nacionalitetin apo gjininë aty ku është e mundshme. Gjitha këto zhvillime japin indikacione se brenda 2-3 viteve Kosova do të përballet me ndryshime të mëdha në tregun e punës dhe intervenimi apo ndryshimi i strategjisë sektoriale do të jetë i domosdoshëm.

Gjithashtu vërehet një mos-unifikim dhe standardizim i punëve në të gjitha komunat, Zyrat e punësimit, Qendrat e aftësimit profesional, Qendrat për punë sociale, Zyrat për komunitete dhe kthim si dhe një nevojë për ngritje të bashkëpunimit në mes këtyre akterëve për realizimin e strategjisë nacionale rreth zbatimit të masave aktive të tregut të punës.

Gjithashtu vlen të përmendet se disa nga institucionet dhe OJQ-të nuk kanë qenë të gatshme për bashkëpunim dhe ndarje të informacionit me ekipin hartues të raportit, me siguri në mungesë të kohës apo edhe informatave që lidhen drejtpërdrejtë me zbatimin e masave aktive të tregut të punës.

Masat aktive të tregut të punës

- **Trajnimi institucional:** nënkupton trajnimin që ofrohet nga tetë Qendrat e aftësimit profesional (QAP) të cilat operojnë nën ombrellën e DPP-së. Qendrat për aftësim profesional (QAP) ofrojnë trajnime falas për punëkërkesit në një profesion të caktuar duke u fokusuar në aplikimin e shkathtësive dhe njohurive praktike dhe përdorur mësimin në klasë si dhe në kabinete të ndryshme. Ofrohen 30 profile të ndryshme me gjithsej 60 punëtori. Aplikohet sistemi modular i trajnimit i cili bazohet në aftësitë individuale të kandidatit. Kandidati pas çdo moduli i nënshtrohet testit dhe krejt në fund atij përfundimtar. Kurset zgjasin gjashtë muaj dhe vetëm pas përvetësimit të shkathtësive, kandidati merr certifikatën.
- **Trajnimi në punë:** Trajnimi në punë ose TNP nënkupton trajnimin nga një punëdhënës që i është ofruar punëkërkesit gjatë angazhimit në punën produktive e cila zhvillon njohuri ose aftësi thelbësore për kryerjen e një pune specifike me një performancë adekuate. Kjo skemë përfshin kompensim mujor jo më të lartë se paga minimale e përcaktuar në Kosovë. (Periudha prej dy deri në gjashtë muaj).
- **Praktika në punë:** PNP është një masë e tregut të punës me qëllim që pjesëmarrësve t'u jepen aftësitë dhe njohuritë e nevojshme për të kryer një punë të veçantë në kuadër të punës dhe mjedisit të punës. PNP mbështet të porsa diplomuarit të kenë qasje në mundësitë e trajnimit dhe të kontaktojnë me punëdhënësit në mënyrë që të përmirësojnë mundësitë e ardhshme për punësim dhe të gjejnë një vend pune. Skema përfshin kompensim mujor që përcaktohet nga MPMS.
- **Subvencionimi në pagë:** Është një program 12-mujor punësimi, përmes të cilit punëdhënësi përfiton subvencion prej 50% për punëmarrës për një periudhë 12 mujore. Pjesëmarrësit në skemën e SPP pritët të mbeten në vendet e punës pas përfundimit të periudhës së subvencionimit. Këto janë transferta të drejtpërdrejta për punëdhënësit për të inkurajuar ata që të punësojnë grupet e caktuara me vështirësi për të gjetur punë. Subvencionet për punësim mund të ndihmojnë punëdhënësit për të zgjeruar biznesin e tyre dhe të punësojnë staf të ri, i cili do të ndihmojë për

të krijuar më shumë vende pune.

- **Punë publike:** Ofrojnë punësim afatshkurtër duke përmirësuar infrastrukturën lokale. Qëllimi i programeve të punës publike janë gjenerimi i punësimit të përkohshëm për të papunësuarit të regjistruar përmes zbatimit të projekteve intensive të cilat absorbojnë fuqi punëtore si dhe mirëmbajtja dhe rehabilitimi i pasurive (aseteve) komunale dhe hapësirave publike;
- **Vetëpunësimi:** Programi i vetëpunësimit është një masë e tregut të punës e cila ndihmon të papunësuarin për nisjen e një biznesi, ose duke u bërë i vetëpunësuar duke i ofruar trajnim dhe këshillim për të zhvilluar e menaxhuar një biznes dhe mbështetjen financiare për të ndihmuar papunësuarit për të nisur një aktivitet biznesi.³



3. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Departamenti i punës dhe punësimit

Të gjeturat kryesore nga monitorimi i Strategjisë

Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës

Strategjia nacionale ka paraparë disa masa aktive lidhur me zbatimin e tyre për komunitetet rome, ashkali dhe egjiptiane. Prej masave të parapara, të cilat përfshijnë trajnimin institucional, trajnimin në punë, praktikën në punë, subvencionimin në pagë, punën publike apo vetëpunësimin, komunitetet rome, ashkali dhe egjiptiane janë të përfshira në shumicën e tyre në një masë të caktuar, përveç tek masa e vetëpunësimit ku ka më së paku zbatim në praktikë.⁴

Duke qenë hartues i këtyre politikave dhe pjesë e krijimit të strategjisë, masat aktive janë prioritet për Agjencinë si dhe përfshirja e Ministrive tjera të linjës si dhe institucioneve tjera, përfshirë Zyrat e punësimit dhe Qendrat për punë sociale janë një domosdoshmëri e patejkalueshme. Nevoja për bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit është më e madhe për shkak të koordinimit të vendeve të lira të punës brenda Agjencisë si dhe koordinimi për pranimin e studentëve si dhe zhvillimin e programeve edukative dhe plan programeve për nevojat e tregut të punës, të cilat mbesin për periudha të gjata të paplotësuara si mungesë e paraqitjes së punëkërkuësve apo mungesës së shkollimit.

Për këtë qëllim Agjencia ka dizajnuar edhe fletushka informuese të cilat u ndahen të gjithë personave që paraqiten në Zyrat e punësimit. Këto fletushka përmbajnë disa informacione bazike si, adresat dhe kontaktet e zyrave, detyrat dhe përgjegjësitë e përgjithshme të zyrave të punësimit, shërbimet specifike për punëkërkuësit si dhe profesionet e trajnimit..

Brenda Agjencisë nuk ka të parapara me organigram pozita të rezervuara për komunitetet rome, ashkali dhe egjiptiane.

Përmes Marrëveshjes së Bashkëpunimit në mes të MPMS/APRK-së dhe VORAE, ka vazhduar bashkëpunimi për përkrahjen e pjesëtareve të komuniteteve rome, ashkali dhe egjiptiane për përfshirjen e tyre në programet e trajnimit në QAP. Në 2018, kryesisht është bashkëpunuar në mbështetjen e këtyre kandidatëve për pjesëmarrje në trajnim në QAP Prishtinë, Ferizaj dhe Prizren.⁵

Mjetet financiare të ndara për strategjinë nacionale janë të pakta dhe sillen rreth tre milionë euro, prandaj Strategjia nuk mund të konsiderohet si strategji zhvillimore, sepse shumica e mjeteve duhet të jetë shumëfish më e madhe për t'u konsideruar si e tillë.

Papunësia e regjistruar sipas etnisë⁶

Entiteti	2018	(%)	Ndryshimi te 2017	Femra	Meshkuj
Shqiptar	80142	83.6%	0.9%	36400	43742
Serb	7358	7.7%	22.1%	3493	3865
Boshnjak	1642	1.7%	3.1%	841	801
Kroat	65	0.1%	-5.8%	30	35
Rom	1753	1.8%	-2.3%	744	1009
Ashkali	2639	2.8%	-0.1%	956	1683
Egjiptian	838	0.9%	16.4%	364	474
Malazez	9	0.0%	12.5%	8	1
Turq	508	0.5%	0.2%	257	251
Tjetër	936	1.0%	-14.2%	454	482
Total	95,890	100%	2.2%	43,547	52,343

4. Shpëtim Kalludra -U.D Drejtor i departamentit për tregun e punës, 10 maj 2019

5. Puna dhe punësimi në Kosovë- Raporti vjetor 2018, Shpend Kalludra intervistë 10 maj 2019

6. Puna dhe punësimi në Kosovë- Raporti vjetor 2018

Bazuar në të dhënat e raportit 2018 nga APRK shihet se komunitetet rome, ashkali dhe egjiptiane marrin pjesë në regjistrime të papunësisë si, romët (1.8%), ashkalinjtë (2.8%) dhe egjiptianët (0.9%). Këto shifra flasin për një angazhim të vogël por aspak të kënaqshëm kur dihet shkalla e papunësisë tek këto komunitete. Numri i përgjithshëm i të punësuarve të komuniteteve rome, ashkali dhe egjiptiane arrin në 5.230 persona.

Punësimet e rregullta sipas etnisë ⁷

Entiteti	Punësimi	(%)	Shp	Nryshime te 2017
Shqiptar	3430	91.1%	4.3%	16.7%
Serb	102	2.7%	1.4%	25.9%
Boshnjak	44	1.2%	2.7%	76.0%
Kroat	-	-	-	-
Rom	38	1.0%	2.2%	31.0%
Ashkali	40	1.1%	1.5%	0.0%
Egjiptian	45	1.2%	5.4%	9.8%
Malazez	-	-	-	-
Turq	22	0.6%	4.3	-12.0%
Tjetër	43	1.1%	4.6%	38.7%
Total	3764	100%	3.9%	17.1%

Të dhënat e paraqitura në tabelën më lartë tregojnë se komunitetet rome dhe egjiptiane gjatë kësaj periudhe raportuese arrijnë të realizojnë disa dhjetëra persona në ndërmjetësime në punësim, mirëpo sa i përket komunitetit ashkali shifrat në rritje mbesin zero, por në numër 40. Gjithsejtë 123 persona kanë përfutur ndërmjetësim.

Aftësimet profesionale sipas etnive ⁸


Entiteti	2018	(%)	ShA	Të Certifikuar	ShÇ
Shqiptar	5267	95.8%	6.6%	4129	78.4%
Serb	15	0.3%	0.2%	10	66.7%
Boshnjak	-	-	-	-	-
Kroat	32	0.6%	6.3%	28	87.5%
Rom	59	1.1%	3.6%	50	84.7%
Ashkali	-	-	-	-	-
Egjiptian	26	0.5%	1.5%	20	76.9%
76.Malazez	60	1.1%	2.3%	54	90.0%
Turq	38	0.7%	4.5%	34	89.5%
Tjetër	-	-	-	-	-
Total	5497	100%	5.7%	4325	78.7%

Nevoja për aftësimet profesionale është shumë e madhe tek të gjithë personat pa përgatitje adekuate profesionale dhe të dhënat tregojnë se komunitetet rome, ashkali dhe egjiptiane gjatë vitit 2018 janë angazhuar në 124 raste.

7. Puna dhe punësimi në Kosovë- Raporti vjetor 2018

8. Puna dhe punësimi në Kosovë, Raporti vjetor 2018

Shkalla e trajnimit sipas etnisë ⁹




Masat aktive ne tregun e punës sipas etnisë ¹⁰

Entiteti	MATP	%	Ndryshimi te 2017	ShA
Shqiptar	2760	92.0%	10.3%	3.4%
Serb	79	2.6%	-49.0%	1.1%
Boshnjak	30	1.0%	66.7%	1.8%
Kroat	1	0.0%	-50.0%	1.5%
Rom	22	0.7%	-18.5%	1.3%
Ashkali	55	1.8%	-22.5%	2.1%
Egjiptian	22	0.7%	46.7%	2.6%
Malazez	0	0.0%	-	0.0%
Turq	13	0.4%	62.5%	2.6%
Tjetër	18	0.6%	-35.7%	1.9%
Total	3000	100%	6.1%	3.1%

9. Puna dhe punësimi në Kosovë- Raporti vjetor 2018

10. Puna dhe punësimi në Kosovë, Raporti vjetor 2018

Shkalla e aktivizimit në PATP sipas etnisë ¹¹



Komuna e Fushë Kosovës

Zyra e punësimit - Fushë Kosovë

Me qëllim të marrjes së informatave sa më të sakta është kontaktuar Zyra e punësimit e cila funksionon në kuadër të Komunës së Fushë Kosovës, në një hapësirë relativisht të ngushtë për kryerjen e punëve të veta, në një zyre të vogël me tre zyrtarë brenda saj. Kjo zyre përballet me një frekuentim të madh të personave të cilët vijnë të kërkojnë vërtetime të papunësisë, ku shumica e tyre janë të komuniteteve pakicë. Distanca në mes të Zyrës së punësimit dhe QPS-së është jo e largët çka u mundëson përfituesve të kenë qasje të lehtë në grumbullimin e dokumentacionit, për dallim me

distancën me Qendrën e aftësisimit profesional e cila gjendet në Prishtinë.

Gjatë takimit me zyrtarët e Zyrës së punësimit janë grumbulluar të dhënat e nevojshme për realizimin e vlerësimit rreth zbatimit të masave aktive të tregut të punës.

Zyra e punësimit është përgjegjëse për zbatimin e masave aktive të tregut të punës. Të dhënat tregojnë për punën e bërë në këtë zyre nga zyrtarët e agjencisë.

Punëkërkuar të regjistruar	278
Punëkërkuar të riaktivizuar	446
Punëkërkuar të transferuar	35
Këshillime	2212
Këshillime në karrierë	268
Këshillime intensive	113
Punëdhënësit e regjistruar	237
Vizita të realizuara	190
Vendet e lira të rregullta	372
Vendet e lira MATP	71
Ndërmjetësime në punë të rregullta	102
Ndërmjetësime në trajnime të rregullta	0
Ndërmjetësime në punë publike	7
Ndërmjetësime në trajnime në punë	5
Ndërmjetësime në punësim	8
Ndërmjetësime në subvencionim	7
Ndërmjetësime në praktikë	15
Referimet në QAP	0
Punësimet pas trajnimit	0
Punësimet pas praktikës	1

Mirëpo të dhënat e vitit 2018 tregojnë se në këto aktivitete numri i përfituesve të pjesëtarëve të komuniteteve rome, ashkali dhe egjiptiane është shumë i vogël. Nga masat aktive të tregut të punës kanë përfutur vetëm pesë raste, të gjithë të komunitetit ashkali, ku katër kanë qenë subvencione dhe një trajnim në punë.¹²

Arsyeja për këtë numër kaq të vogël është sepse mungon mësimi bazik i pjesëtarëve të komuniteteve, çka është edhe kriter për ndjekjen e kurseve dhe angazhimeve në njërin nga masat aktive të tregut të punës.

Zyra e punësimit në kuadër të MPMS-së në secilën situatë bën përpjekje për informim të qytetarëve për masat aktive të tregut të punës, duke shpërndarë fletushka informuese, vendosjen e shpalljeve në objekt si dhe përpjekjet përmes shpalljeve të ndryshme në situata të ndryshme të bëjnë informim.

Organizatrat nuk kanë të parapara ndonjë organigram i cili ka vende të rezervuara për komunitete. Të gjitha rastet të cilat vijnë dhe kërkojnë vërtetim për plotësimin e dokumentacionit për asistencë sociale pajisen me vërtetim, sepse ne si zyre nuk kemi pasur mundësi asnjëherë që t'u ofrojmë punë atyre, dhe ata të refuzojnë dhe ne mos të lëshojmë vërtetimin e kërkuar.¹³

QPS Fushë Kosovë

QPS Fushë Kosovë është institucion komunal i mandatuar për ofrimin e shërbimeve sociale profesionale dhe skemës së asistencës sociale. Për realizimin e vlerësimit puna është e bazuar kryesisht me shërbimin e departamentit të skemës së asistencës sociale, andaj edhe intervista është realizuar me stafin përgjegjës të QPS për ofrimin e këtyre shërbimeve.

Qendra për punë sociale përballet me një numër të madh të familjeve përfutuese të skemës së asistencës sociale, ku pjesë e konsiderueshme e tyre i takojnë komuniteteve rome, ashkali dhe egjiptiane. Nga numri prej rreth 840 familjeve, 430 u takojnë komuniteteve, kurse 300 nga to janë të komuniteteve rome, ashkali dhe egjiptiane.¹⁵

Shqetësim mjaft i madh është se shumica e tyre,

Zyrës së punësimit i mungon edhe informacioni për numrin e studentëve të cilët gjenden në studime, qoftë në kolegje private apo shtetërore.

Të dhënat e Zyrës së punësimit tregojnë se të regjistruar dhe që presin punë nga komunitetet rome, ashkali dhe egjiptiane janë - gjashtë romë, 50 ashkali dhe pesë egjiptianë, e që fatkeqësisht të gjithë janë pa përgatitje shkollore.¹⁴

Janë disa kompani që bashkëpunojnë më ngushtë me Zyrën e punësimit, si "Euroloni", "Elektro Jaha", të cilat marrin punëtorë përmes Zyrës tonë dhe kërkojnë punëtorë nga ne, si fabrikat për riciklim të plastikës, për të cilat punë nuk kërkohet asnjë përgatitje shkollore.

Meqenëse shumë nga punët e ofruara janë afatshkurtra, shumica e popullatës së komunitetit hezitojnë të angazhohen nga frika se do t'u ndërpritet ndihma sociale dhe kthimi në asistencë sociale ju merr kohë prapë.

apo rreth 90%, i takojnë kategorisë së dytë,¹⁶ të cilët janë të obliguar të aplikojnë çdo gjashtë muaj në Qendër për punë sociale. Kategoria e dytë një nga kriteret bazë e ka të këtë një anëtar të familjes të aftë për punë. Aplikimi çdo gjashtë muaj paraqet problem të madh jo vetëm për stafin e QPS-së por edhe për Zyrën e punësimit pasi që para secilit ri-aplikim nevojitet certifikata nga Zyra e punësimit.

Sa i përket masave aktive të tregut të punës të parapara në strategjinë nacionale, zyrtarët e asistencës sociale janë shumë pak të njoftuar lidhur me këto masa, pasi që shumica e përfutuesve e kanë mundësinë e njohjes me këto masa në Zyrat e punësimit me rastin e marrjes së certifikatës. Në QPS nuk ka asnjë informator lidhur me njoftimin për masat aktive të tregut të punës e që nga stafi

12. Nexhmije Plana - Zyra e punësimit, Komuna e Fushë Kosovës

13. Intervista - Teuta Brisku, 13 maj 2019, Zyra e punësimit

14. Teuta Brisku - Këshilltare për punësim

15. Bajram Marolli - Zyrtar i asistencës sociale, QPS Fushë Kosovë, 13 maj 2019

16. Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 2003/15 për skemën e ndihmës sociale në Kosovë, Neni 4, pika 4.5

konsiderohet si mjaft e dobishme të kenë diçka të tillë. "Nuk jemi të informuar dhe nuk na informon askush përmes trajnimit apo ngjashëm"¹⁷ shprehet zyrtari i shërbimeve sociale.

Komuna dhe shërbimet sociale po ashtu janë duke u përballur me sfida të mëdha për shkak të numrit të madh të personave të riatdhesuar brenda komunës.

Vlen të theksohet se familjet e komunitetit rom ballafaqohen edhe me probleme tjera, ku, sipas zyrtarit të asistencës sociale, numër i madh i tyre në mungesë të njohjes së shkrim-leximit, pasi që ka persona që nuk kanë vijuar as mësimin në nivelin primar, detyrohen që dokumentet e plotësuar në vend të nënshkrimit të merren me shenja të gishtërinjve.

Familjet e komuniteteve rome, ashkali dhe egjiptiane përballen me numër të madh të fëmijëve në njërin anë, përderisa në anën tjetër kriter ligjor është që familja të ketë një fëmijë nën moshën pesëvjeçare në mënyrë që të marrin asistencën sociale nga kategoria e dytë. Mirëpo shpesh paraqitet problem për familjet e komuniteteve, sepse ka shumë familje që kanë fëmijë nën moshën pesëvjeçare, por kanë edhe më shumë së një anëtar të aftë për punë brenda familjes mbi moshën 18-vjeçare e që është pengesë ligjore për realizimin e asistencës sociale.

Disa fushata të realizuara nga OJQ-të lidhur me informimin e tyre për mundësinë e ndjekjes së

kurseve në Qendrën e aftësimit profesional kanë dështuar pikërisht pasi që nuk kanë asnjë vit shkollim dhe kriter për aftësim është posedimi i një shkollimi bazik.

Komuna e Fushë Kosovës përballlet me numër të madh të personave që kanë migruar edhe brenda vendit, përfshirë edhe të riatdhesuarit.

Brenda QPS-së nuk kanë pasur asnjë rast të largimit të ndonjë familje, kur nga Zyra e punësimit, përfshirë njërin nga masat aktive të tregut të punës u është afruar punësim dy herë radhazi,¹⁸ ashtu siç e parasheh edhe udhëzimi administrativ dhe dikush e ka refuzuar e është eliminuar.

Rekomandim nga QPS Fushë Kosovë është që Agjencia dhe bizneset të bëjnë përpjekje të hapin sa më shumë vende pune të cilat nuk kërkojnë ndonjë përgatitje të lartë arsimore, sepse në këtë formë mundësia e angazhimit të komuniteteve do të ishte shumë më e madhe, duke marrë parasysh që pjesa dërrmuese e tyre nuk zgjedhin punën, por nuk e kanë mundësinë. Komuna e Fushë Kosovës ka rreth 10% minoritete e ku vetëm 0.5% e tyre janë të punësuar.

Rekomandim tjetër është qasja në bazën e të dhënave të Zyrës së punësimit ku QPS do të ishte në gjendje të nxjerrë vet dokumentacionin e punësimit si dhe largimi i ri-aplikimit çdo gjashtë muaj, sepse është ngarkesë e madhe për stafin e QPS-së rrjedhimisht edhe mundësia e punës në terren është shumë e vogël.

Zyra për komunitete dhe kthim - Fushë Kosovë

Zyra për komunitete dhe kthim është e vendosur brenda Komunës dhe shumë afër kabinetit të Kryetarit të Komunës. ZKK merret me çështjen e problemeve të personave të riatdhesuar përfshirë tri komunitetet rome, ashkali dhe egjiptiane, duke filluar nga ushqimi, strehimi por edhe aftësimi për punësim përmes masave aktive të tregut të punës, në bashkëpunim me Qendrat e aftësimit profesional dhe me Qendrën për punë sociale në anën tjetër për ofrimin e asistencës sociale e shërbimeve sociale profesionale.

Zyra për kthim dhe komunitete nuk është e njoftuar me strategjinë nacionale për punësim. Janë rreth 125 persona, përfshirë familje dhe individë, të cilët janë kthyer vetëm brenda vitit 2018. Në kuadër të tyre janë edhe 20 ashkali, tre romë dhe tre egjiptianë.¹⁹ ZKK ka një numër marrëveshesh bashkëpunimi me disa organizata joqeveritare, mirëpo edhe në këtë situatë problemi themelor qëndron tek këta persona, respektivisht mungesa e përgatitjes profesionale, apo më mirë të thuhet, shumë shpesh edhe te edukimi primar apo sekondar i tyre. Të gjithë personat të cilët kanë nevojë për të

17. Bajram Marolli - Zyrtar i asistencës sociale QPS Fushë Kosovë, 13 maj 2019

18. Udhëzimi Administrativ Nr. 03/2013 për procedurat e regjistrimit, certifikimit dhe kërimit aktiv të punësimit për të papunësuarit që aplikojnë në skemën e ndihmës sociale

19. Zoran Mikiq - Zyra për komunitete dhe kthim, Fushë Kosovë

fituar duhet të hartojnë një plan biznesi dhe pjesëtarët e komuniteteve rome, ashkali dhe egjiptiane nuk kanë përgatitje për të hartuar një plan biznesi. Në anën tjetër shumë individë dhe familje kanë marrë vendime pozitive, mirëpo asnjëherë nuk kanë marrë grantet e premtuara. Komuna e Fushë Kosovës ka nënshkruar së fundi një marrëveshje me Caritas, ku kjo e fundit do të ndajë 21.000 euro ndërsa 9.000 do të ndahen nga Komuna.²⁰

Komuna e Obiliqit

Zyra e punësimit - Obiliq

Komuna e Obiliqit është komunë me një përbërje të nacionaliteteve dhe komuniteteve të ndryshme. Brenda komunës funksion Zyra e punësimit, e cila është në afërsi të Qendrës për punë sociale. Zyra e punësimit në Komunën e Obiliqit është aktive karshi rolit dhe përgjegjësi që mban dhe është bashkëpunuese me gjithë partnerët brenda komunës, me bizneset dhe me qytetarët e saj. Zyrtarët e saj janë mirë të informuar dhe zbatues në praktikë të masave aktive të tregut të punës, me aq sa janë kapacitetet e bizneseve ofruese dhe kërkuar të punëtorëve.

Brenda Zyrës së punësimit punohet në zbatimin e masave aktive të tregut të punës, si dhe posedojnë të dhëna, të cilat janë paraqitur edhe në këtë vlerësim.

Janë në funksion të gjitha masat si:

- Trajnimi institucional
- Trajnimi në punë
- Praktika në punë
- Subvencionimi në pagë
- Puna publike
- Vetëpunësimi

Numri i përfituesve të masave aktive brenda komunës së Obiliqit gjatë vitit 2018 ka qenë 124 në total, ku katër nga ta kanë qenë romë, një egjiptian dhe tetë ashkali.²¹

Probleme të theksuara paraqiten edhe në Qendrën për aftësi profesionale sepse numri i madh i të kthyerve dhe të tjerëve ka ndikuar që të mos arrihet të ofrohen trajnime për të gjithë. Komuna po dërgon nga 10 veta për të ndjekur këto trajnime. Komuna në bashkëpunim me një OJQ tjetër ka filluar edhe një projekt për mësimin e shkrim-leximit për komunitetet, por as kjo nuk ka rezultuar shumë pozitive deri më tani.

Kur bëhet fjalë për zbatimin e masave aktive të tregut të punës, bazuar në strategjinë nacionale të MPMS-së, Zyra e punësimit në shumë raste detyrohet të bëjë përjashtime nga kriteret e përcaktuara për komunitetet rome, ashkali dhe egjiptiane si dhe për të riatdhesuarit. Arsye për këtë janë: pa përgatitja shkollore adekuate apo moshë e shtyrë si kriter që i përjashton. Përpjekjet e Zyrës janë që të përfshihen sa më shumë të gjithë aplikuesit.²²

Masa aktive të cilat janë zbatuar deri më tani për komunitetet rome, ashkali dhe egjiptiane janë 15 nga 124. Zyra e punësimit - kriteret për masat aktive nuk aplikohen për komunitetet dhe për të riatdhesuarit, sikur për komunitetin shqiptar.

Shumë herë, edhe pa shqyrtim adekuat, këta i qasen masave aktive sepse e dinë se nuk kanë përgatitje dhe nuk janë të moshës adekuate. Punësimi i rregullt po shkon më vështirë dhe po ndikon në punësim të rregullt, sepse kompanitë duan ta shfrytëzojnë një përfitim nga Agjencia e punësimit, 150 euro apo 250 euro, e që gjithë kjo ndikon drejtpërdrejt.

Sa i përket komuniteteve, kriteret e shqyrtimit apo moshës, ne i kemi tejkaluar dhe nuk i kemi zbatuar si për të tjerët me qëllim që të aktivizohen edhe në punë e trajnime.

²⁰. Po aty

²¹. Isak Ahmeti - Zyra e punësimit, Komuna e Obiliqit 14 maj 2019

²². Intervista me Emine Berisha - Zyra e punësimit, 14 maj 2019

Masa aktive

Punësim i rregullt - 30 kompani mbi 130 herë kanë kërkuar punëtorë përmes Zyrës së punësimit dhe numri është mjaft i madh i punëtorëve që ata kanë kërkuar, por ne nuk kemi arritur t'u sigurojmë aq punëtorë sa ata kanë kërkuar. Në shumicën e rasteve nuk kemi pasur mundësi t'u përgjigjemi pozitivisht në mungesë të punëtorëve të trajnuar dhe certifikuar, apo edhe të regjistruar në Zyrën e punësimit.

- Trajnim në punë - 19 raste
- Subvencionim - 14 kompani të ndryshme kanë kërkuar 18 herë 26 vende subvencionim në pagë
- Praktikantë - 23 vende
- Vetëpunësim - 18 raste

Sistemi nuk e ka të zhvilluar mundësinë që nëse dikujt iu ka ofruar dy herë puna me automatizëm të pamundësojë lëshimin e vërtetimit për ndihma sociale. Këshilltari nuk ka një buton i cili e fshin, përveç në raste kur personi i mbush 65 vite.

Bashkëpunimi me kompani është arritur përmes punës së këshilltarit dhe promovimit të punës në terren si dhe takimeve të rregullta me kompanitë e zonës. Njëherë ne kemi dalë në terren dhe me pas vet kompanitë paraqiten në Zyrat e punësimit.²³ Puna e përkushtuar e këshilltarit të punësimit ka ndikuar të arrihet deri tek këto rezultate.

Zyra e punësimit gjithashtu u ofron informim për shërbimin dhe mundësinë përmes internetit, telefonit celular, takimeve të drejtpërdrejta, duke iu përshtatur kështu nevojave të punëdhënësit.

Niveli i papunësisë në Obiliq është i madh, ku janë të evidentuar punëkërkues të regjistruar 1.694 aktiv të papunë. Prej tyre 177 janë romë (meshkuj 128 dhe femra 49), ashkali 82 (meshkuj 72 dhe femra 10), egjiptianë katër (tre meshkuj dhe një femër)²⁴

Numri i përgjithshëm i punëkërkuesve, përfshirë edhe ata pasiv, është 4.187 veta, disa nga ta të punësuar përmes subvencioneve, kanë kontrata afatshkurtra.

Ka raste kur kompania nuk pranon pjesëtarë të komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptiane. Krejt kjo për arsye se komunitetet romë, ashkali dhe egjiptiane nuk kanë qëndrueshmëri në punë dhe nuk e mbajnë punën e ikin, gjë që ka krijuar pasiguri të kompanitë, pasi që ata e braktisin punën shumë shpejt.

Ata të cilët nuk e kanë plan të shkojnë në vetëpunësim nuk kanë nevojë të shkojnë në QEAP²⁵

Njëkohësisht, Zyra është duke punuar ngushtë edhe me MASHT-in për kushtëzimin e ndjekjes së kurseve të gjuhës dhe shkrim-leximit.



23. Intervista me Emine Berisha - Zyra e punësimit, 14 maj 2019

24. Intervista me Emine Berisha - Zyra e punësimit, 14 maj 2019

25. Intervista me Emine Berisha - Zyra e punësimit, 14 maj 2019

Qendra për punë sociale - Obiliq

Qendra për punë sociale është institucion i një niveli lokal i cili ofron shërbime sociale profesionale por edhe skemën e ndihmës sociale për qytetarët në gjendje të nevojës sociale.

Në QPS Obiliq përfitues të asistencës sociale janë 890 familje.

Nga ky numër janë:

- Romë, 198 familje
- Ashkali, 62 familje
- Egjiptianë, pesë familje ²⁶

Kur bëhet fjalë për komunitetet rome, ashkali dhe egjiptiane të cilët janë përfitues të SAS, me theks të veçantë dominon kategoria e dytë - pra familjet që kanë një anëtar të familjes së aftë për punë dhe i papunë. Kjo paraqet sfidë për zyrtarët e asistencës sociale, sepse kategoria e dytë duhet të ri-aplikojë çdo gjashtë muaj dhe numri i madh i dokumenteve e letrave që duhet të plotësohen paraqesin vështirësi për stafin e QPS-së si dhe kufizon punën në terren edhe ashtu të një numri të vogël të stafit të punësuar në QPS.

Përderisa Zyra e punësimit ofron një numër të madh të vendeve të punës, në QPS Obiliq, nuk është evidentuar asnjë rast që një familje të mos ketë mundësi të pajiset me vërtetimin e papunësisë nga Zyra e punësimit.

Në kuadër të bashkëpunimit të QPS-së me Zyrën e punësimit në shumicën e rasteve shkëmbehen informatat dhe angazhohen punëtorët e QPS-së për gjetjen dhe ftesën e familjarëve për t'u angazhuar në punë të cilat ofrohen nga bizneset të cilat operojnë brenda komunës.

Stafi i QPS-së nuk ka pasur ndonjë trajnim apo informacion lidhur me strategjinë nacionale të MPMS-së, çka shihet se është një mungesë.

Zyrtarët e QPS-së insistojnë në secilën situatë të kenë në posedim vërtetimin e vijimit të mësimit për fëmijët e komuniteteve rome, ashkali dhe egjiptiane, në mënyrë që ata të plotësojnë kriterin e paraparë në Ligjin për SAS si dhe kjo është në interesin e familjeve për të ardhmen.

Së fundi brenda QPS-së janë vendosur disa fletushka informuese në koridore ku kanë qasje të gjithë klientët, përfshirë edhe përfituesit e SAS-it.

Shumë nga familjet përfituese të SAS e shohin këtë ndihmë si pagë mujore, edhe pse është mjaft e vogël, dhe shumë raste kanë frikë se nëse punësohen për një periudhë të shkurtër kohore, ata do të mbesin pa ndihmë sociale, pasi që e llogarisin si të hyrë të garantuar e të sigurt. ²⁷

Mirëpo, në anën tjetër, është një shqetësim i madh për komunitetin, pasi që përgatitja arsimore e ulët nuk mundëson pozita të mira në kompanitë që kërkojnë punëtorë. Në anën tjetër, ka edhe raste kur kompanitë të cilat kërkojnë punëtorë nuk i përzgjedhin apo preferojnë personat nga komunitetet rome, ashkali apo egjiptiane. Me rastin e kontaktimit nga ana e QPS-së familjet hezitojnë të punësohen në kompani të cilat janë jashtë komunës së Obiliqit, edhe pse shumë nga to sigurojnë edhe transport, ushqim e siguri në punë. Pagat e ofruara në secilin rast janë prej dy deri katër herë më të mëdha se sa shuma e ndihmës sociale për tërë familjen.

26. Fatime Halimi - Udhëheqëse e asistencës sociale, QPS Obiliq

27. Fatime Halimi - Udhëheqëse e asistencës sociale, QPS Obiliq

Zyra për komunitete dhe kthim - Obiliq

Zyra për komunitete dhe kthim funksionon brenda Komunës së Obiliqit. Në përbërjen e saj janë të angazhuar staf i nacionaliteteve të ndryshme. Stafi i cili është i angazhuar brenda ZKK në kuadër të përgjegjësisë të saj, kryen shërbime për gjithë qytetarët e rikthyer, pa asnjë dallim.

Komuna e Obiliqit ka në shumicë komunitetin rom, pastaj ka ashkali dhe shumë pak egjiptianë. Numri i familjeve të riatdhesuarve gjatë vitit 2018 është 34, prej të cilave shtatë janë familje rome, tre familje ashkali dhe një individ egjiptian.²⁸ Sistemet ekzistojnë, por ato nuk janë të furnizuara mirë me informata dhe jo të gjithë të punësuarit e njohin sistemin, prandaj shpesh ka mungesë informatash. Numri i atyre që kanë përfituar nga planet e biznesit ka qenë 33, gjersa nga viti 2016, rreth 10 raste kanë përfituar nga planet e biznesit²⁹

Jemi të njoftuar shumë mirë me masat dhe tashmë, pas ndryshimit të rregullores, Rregullorja 13/2017 aplikohet për secilin rast në Zyrën e punësimit .

Planet e biznesit janë rreth 40% të qëndrueshme, sidomos ata që kanë përfituar bagëti apo pajisje kanë rezultuar pozitivisht, kurse disa tjera kanë dështuar.

Bashkëpunimi mes QPS-së, ZP-së e UNDP-së është një ndërlidhje shumë e mirë e cila duhet të vazhdojë edhe në të ardhmen.

Posedojmë fletushka dhe letra informuese për palët dhe ua japim ato palëve si URA, DIAKONIA, GIZ, UNDP. Nuk ka vende të rezervuara për punësime të komuniteteve në organigram të Komunës. Me Drejtorinë e arsimit është një bashkëpunim shumë i mirë dhe kjo ndikon jashtëzakonisht mirë në identifikimin e informimin e punëkërkesve. Komuna e Obiliqit ka të zhvilluar strategjinë lokale për komunitetet rome, ashkali dhe egjiptiane 2017-2021, respektivisht dy strategji, njëra njëvjeçare dhe tjetra pesëvjeçare.



Strategji lokale për Komunitetet

28. Shaban Berisha - Zyra për komunitete dhe kthim, Komuna e Obiliqit

29. Mirvete Paloqi - Zyra për komunitete dhe kthim

Qendra e aftësimit profesional – Prishtinë (Fushë Kosovë dhe Obiliq)

Qendra e aftësimit profesional në Prishtinë është përgjegjëse për aftësimin për rajonin e Prishtinës në kuadër të së cilës bëjnë pjesë edhe Komuna e Fushë Kosovës dhe Obiliqit. Vendndodhja e Zyrës mundëson që qytetarët në nevojë për aftësim profesional të kenë qasje të lehtë, pasi që gjendet afër transportit publik për dy komunat e lartcekura. Në vazhdim janë disa nga të gjeturat e intervistimit të realizuar me përgjegjësit e Qendrës.

Kurset që ofrohen në QAP – Prishtinë (Fushë Kosovë dhe Obiliq)

- Rrobaqepësi
- TIK Teknologji informuese dhe komunikuese
- Elektronikë industriale
- Asistent administrativ
- Administrim biznesi
- Servisim i pajisjeve të zyrës
- Patisieri, gatues ëmbëlsirash
- Furrтари, gatues brumërash
- Ujësjellës dhe kanalizim
- Ngrohje qendrore
- Auto-elektrikë
- Ndërtimtari
- Profili i ndërtimtarisë me tetë profesione
- Vetëpunësimi - ndërmarrësi kryesisht për të riatdhesuarit trajnim dyjavor ose 50 orë mësimi

Kapacitetet e QAP-it janë prej 800 deri në 100 maksimumi. Gjatë vitit 2018 kanë qenë rreth 659 përfutues nga të cilët 418 janë meshkuj dhe 241 femra. 32 persona janë certifikuar nga komunitetet, prej të cilëve 19 femra dhe 13 meshkuj.³⁰

Pjesëtarët e komuniteteve kryesisht ndjekin kurse: dy ndërtimtari, dy gatues ëmbëlsirash patisieri, dy TIK, 12 rrobaqepësi, një auto-elektrikë, tre furrтари e gatues brumërash, katër ngrohje, një ujësjellës dhe pesë vetëpunësim.

Te gjitha shtetet të cilët e kanë njohur Kosovën i njohin certifikatat dhe tek profesioni i furrtarisë ka qenë një fluks i madh ku vetëm gjatë vitit 2016 kemi certifikuar mbi 400 persona dhe shumica nga ta kanë qenë duke punuar në Hungari. Shteti hungarez i ka kushtëzuar ata që të pajisen me certifikatë dhe ka pasur një invazion për t'u certifikuar dhe për të ruajtur vendin e punës.

Në Fushë Kosovë janë të orientuar në masat aktive trajnim në punë dhe kjo ka pasur relativisht sukses. Niveli i shkollimit të komuniteteve është zero. Matematikë nuk dinë, vijnë qëndrojnë disa ditë dhe ikin. Atyre që e ndërprejnë trajnimin nuk u lëshohet certifikata, përderisa ata që e ndjekin atë certifikohen si gjithë të tjerët.

Shumica prej tyre fillimisht orientohen në profesione të vrazhda. Me profesione të vrazhda nënkuptojmë ujësjellës, ndërtimtari, ngrohje, auto-elektrikë, krejt çka nuk kryhet punë me kompjuter dhe teori ku duhet me shumë shkrim-lexim.

Janë dy lloje profesione të vërtetuara dhe të pavërtetuara dhe për herë të parë janë akredituar nga QAP në vitin 2012. Të vërtetuara janë katër profesione - Asistent administrativ, TIK, ujësjellës dhe ngrohje, andaj edhe certifikatat njihen dhe për këtë arsye ato profesione jo të vërtetuara.

Përparësia e vërtetimit është se ka kritere që Autoriteti kombëtar i kualifikimeve i kërkon. Në vitin 2015 jemi riakredituar dhe tash prapë në vitin 2018 kemi ri-aplikuar dhe ky ri-akreditim kërkohet të bëhet çdo tre vjet.³¹

Te profesionet e vërtetuara kanë vështirësi të kyçen dhe shumë herë nuk arrijnë ta bëjnë sepse kriter bazë është shkolla e mesme dhe komunitet e kanë këtë pengesë, prandaj shumica orientohet në profesione të vrazhda, aty ku nuk kërkohet shkolla e mesme, pasi që rregullat dhe kriteret e autoritetit janë të tilla.

30. Zejnullah Rustemi – Qendra e aftësimit profesional, Prishtinë, maj 2019

31. Zejnullah Rustemi – QAP Prishtinë

Komunitetet kanë prioritet dhe përparësi në kycje për trajnim për dallim prej tjerëve dhe në gjithë lëmë një numër të caktuar të lirë për ta për çdo rast. Kjo paraqet një diskriminim për persona të cilët presin periudhë të gjatë ndërkohë që ne e kycim një pjesëtar të komuniteteve pakicë me urgjencë dhe pa kriter.³²

Mundohemi t'u ofrojmë shumë. Vijnë dhe ikin e kërkojnë profesione për të cilat ata nuk janë. Na pengon shumë që nuk e kanë shkolim për atë që kërkojnë dhe njohja e shkrim-leximit është kushti minimal. MASHT ofron kurse trajnimi për mësimin e shkrim-leximit gjë që po na ndihmon neve, sepse nëse nuk dinë të bëjnë matjen, të lexojnë specifikacionin, të bëjnë llogaritjen më të thjeshtë të mundshme....³³

Marrë parasysh numrin e gjithmbarshëm, numri prej 32 personave është i kënaqshëm dhe ata punësohen në komunitetin ku jetojnë dhe e shpërndajnë zanatin tek anëtarët e vet si dhe tek komunitetet.

Këshilltarët e ZP i orientojnë tek QAP dhe i regjistrojnë. QAP punon përmes trajnerëve që t'i bindim të qëndrojnë në trajnime, ku fillimisht e kanë një punë provuese.

Trajnerët janë të përgatitur profesionalisht, por QAP ka nevojë për trajnerë që e njohin gjuhën e tyre. Disa dinë vetëm serbisht. Nuk ka asnjë trajner serb dhe ka që nuk e dinë gjuhën shqipe. Po ashtu edhe gjuhën rome. Literatura e tëra është në gjuhën shqipe.

Trajnimit në punë shpesh kryhet nëpër kompani të ndryshme dhe QAP përherë ka të angazhuar një trajner i cili merret me ta. Trajneri fillon angazhimin pas përfundimit të aktivitetit me kandidatë dhe detyrat e trajnerit janë që të marrë planin individual nga ZP, të bashkëpunojë me mbikëqyrësin e personit i cili do të trajnohet në kompani dhe në

varësi të profesioneve e bëjnë planin e trajnimit se për çka do të trajnohet, respektivisht trajneri bashkë me një mbikëqyrës të një klienti/punëtori pajtohen se çka ka do të mësojë gjatë qëndrimit në vendin e punës. Pas planit bën monitorimin e kandidatit/kandidates përgjatë periudhës tremujore, së paku një herë në muaj. Pas monitorimit bën edhe vlerësimin. Trajneri bashkë me mbikëqyrësin i vlerësojnë të arriturat e kandidatit në vendin e punës dhe nëse nuk janë arritur rezultatet ata japin rekomandim për vazhdimin e periudhës e trajnimit për një kohë të caktuar. Gjatë kësaj periudhe paguhet në shumën prej 150 eurosh. Në rast se i ka arritur rezultatet e pritura atëherë certifikohet dhe pajiset me certifikatë nga QAP. Në certifikatë figuron se kush e ka përkrahur këtë MATP, UNDP, LUX apo ndokush tjetër.

Sa i përket transportit dhe shpërndarjes së informacionit, apo edhe ndonjë ndihme tjetër logjistike, ekziston bashkëpunim me OJQ të ndryshme të cilat janë të gatshme t'i përkrahin komunitetet, gjë që e lehtëson shumë procesin e zbatimit të MATP-ve.

Edhe QAP në Prishtinë, sikurse edhe QAP në Komunën e Gjakovës e Prizrenit, ka një bashkëpunim të mirë me zyrat e punësimit, përderisa me QPS dhe të tjerët bashkëpunimi dhe këmbimi i informatave është shumë i zbehtë.

Komunitetet kryesisht kërkojnë moto-kultivatorë për punë në terren dhe grumbullim mbeturinash, pasi që nuk ka ndonjë kushtëzim nga shteti për punë dhe është evidente se shumë nga ta mbijetojnë dhe sigurojnë të ardhura për familje nga kjo punë.

32. Zejnullah Rustemi – QAP Prishtinë

33. Zejnullah Rustemi – QAP Prishtinë

Komuna e Gjakovës

Zyra e punësimit - Gjakovë

Komuna e Gjakovës është një qytet i përbërë nga nacionalitete të ndryshme, ku komunitetet rome, ashkali dhe egjiptiane janë pjesë përbërëse me një proporcion të përafërt mes veti.

Numri i bizneseve të paraqitura në Zyrën e punësimit në Gjakovë është 838. Sa i përket profesioneve, më të kërkuarat në Zyrën e punësimit janë: Ndërtimtaria, zdrukthëtaria, rrobaqepësia, metalpunues dhe mirëmbajta e objekteve përmes pastrimit.

Masat aktive të tregut të punës bazuar në strategjinë nacionale të MPMS-së të zbatuara për komunitetet rome, ashkali dhe egjiptiane janë: trajnimi në punë dy raste, subvencionimi në pagë dy raste, punë publike tre raste dhe shtatë raste vetëpunësimi. Gjithsejtë janë 14 raste³⁴

Tabela ³⁵

1	Trajnimi në punë	dy raste
2	Subvencionimi në pagë	dy raste
3	Puna publike	tre raste
4	Vetëpunësimi	shtatë raste
Gjithsejtë të angazhuar gjatë vitit 2018 nga komunitetet rome, ashkali dhe egjiptiane		14 raste

Zyra e punësimit i viziton bizneset dhe i njofton ato në tri forma: përmes vizitave në terren, telefonit dhe postës elektronike, megjithatë informimin e bizneseve më së shumti e bëjmë përmes postës elektronike.

Muajt e fundit bizneset janë më shumë të interesuara për shkak të mungesës së punëtorëve, ikja e të rinjve dhe çdo ditë kemi thirrje ku ato kërkojnë të punësojnë njerëz. Është shumë me rëndësi të përmendet se nuk ka ndonjë përzgjedhje të nacionaliteteve dhe angazhimi i komuniteteve është shumë i dëshiruar nga bizneset, njëjtë sikur edhe shqiptarët. ³⁶

Subvencionimi nga UNDP dhe MPMS është i vazhdueshëm për nëntë muaj radhazi. Deri më tani nuk kemi pas asnjë rast që e kemi informuar dy herë

për punë ndonjë personi, qoftë komuniteteve apo tjerëve, dhe në asnjë rast nuk kemi ndalur vërtetimin.

Për herë të parë kemi pasur trajnim për strategjinë nacionale dhe masat aktive të tregut të punës nga WYG International ku edhe jemi njoftuar për to, pasi që para këtij trajnimi nuk kemi pasur informata lidhur me atë se çka parasheh strategjia nacionale e MPMS-së.

Fushata janë bërë kohë pas kohe, sidomos muajt e fundit, përfshirë edhe panairin e punës e organizuar me GIZ. Por jo vetëm gjatë fushatave, këshilltarët merren me secilin rast kur palët shkojnë për vërtetim të papunësisë gjë që shfrytëzohet të kryhet edhe pjesa e këshillimit.

34. Arbër Zhubi – Këshilltar i punësimit - Zyrtar për shërbime të punësimit, 20 maj 2019

35. Arbër Zhubi – Këshilltar i punësimit - Zyrtar për shërbime të punësimit, 20 maj 2019

36. Arbër Zhubi – Këshilltar i punësimit - Zyrtar për shërbime të punësimit, 20 maj 2019

"Kemi pasur rast kur kemi pasur kërkesa për rrobaqepës nga kompani të ndryshme ku kanë kërkuar me qindra persona dhe Zyra e punësimit nuk ka pasur mundësi t'ua ofrojë. Janë ftuar edhe komunitetet, por edhe të tjerët, dhe i kemi njoftuar përmes telefonit, sidomos ata që kanë kryer kursin apo kanë shprehur gatishmëri për rrobaqepësi".³⁷

Projekte të ndryshme kërkojnë motra medicinale dhe teknik medicinal, por edhe profesione tjera, megjithatë Zyra e punësimit ka pasur shumë pak mundësi përkrahjeje, sepse kuadro të tilla nuk ka në regjistrë të pritjes për punë.

Kurset e ofruara nga Qendra e aftësimit dhe riaftësimit profesional për të punësuarit dhe punëkërkuesit, bazuar në sistemet modulare që ofrohen në Qendrën trajnuese në Gjakovë janë:

1. Rrobaqepësi
2. Menaxhimi i ndërmarrjeve mikro dhe të vogla
3. Vetëpunësim
4. Parukier
5. Grimere
6. Instalues elektrik
7. Saldim
8. Asistent administrativ
9. Kontabilitet

Zyra e punësimit konsideron se janë mjaftueshëm të informuar lidhur me MATP dhe kanë konsulta të vazhdueshme me akterët të cilët i promovojnë masat aktive te tregut të punës. Bashkëpunimi i aktorëve si QPS, ZKK dhe QAP është i kënaqshëm pasi që mbahen takime të vazhdueshme.

Numri i përgjithshëm i punëkërkuesve për vitin 2018 ne Zyrën e punësimit në Gjakovë nga komunitetet rome, ashkali dhe egjiptiane është 16. Sfidat e Zyrës së punësimit janë të shumta. Si sfida në vete është mosparaqitja e vendeve të punës nga ana e kompanive të zyrat e punësimit, pasi që vetëm ato vende të cilat nuk mundën të plotësohen nga ana e kompanisë, vijnë dhe i kërkojnë te Zyra e punësimit. Po ashtu sfida për zyrtarët për shërbime të punësimit është edhe mosgatishmëria për punësim e atyre të cilët marrin ndihmë sociale, sepse nuk kanë vullnet për punë dhe dëshirojnë të jetojnë me

ndihma apo dëshirojnë t'i marrin këto ndihma dhe të punojnë pa u paraqitur në ATK. Një sfidë tjetër kohëve të fundit është migrimi i të rinjve në vendet evropiane ku vërehet dukshëm mungesa e fuqisë punëtore në gjithë Republikën e Kosovës, por edhe në Gjakovë.³⁸

Sa i përket punësimit të komuniteteve është e dukshme që atyre u nevojitet më shumë shkollim dhe aftësim profesional sepse vërehen raste të shumta kur nuk kanë shkollimin dhe aftësimin profesional. Ndërsa, sa u përket institucioneve, besoj se në vazhdimësi janë të inkurajuar mjaftueshëm për angazhimin e tyre në tregun e punës, punë të rregullt dhe MATP.

Qendra për punë sociale - Gjakovë

Qendra për punë sociale në Gjakovë është institucion publik i nivelit komunal kompetent për ofrim të shërbimeve sociale profesionale dhe asistencës sociale. Numri i madh i rasteve në nevojë për shërbime sociale dhe asistencë sociale si dhe mungesa e stafit profesional adekuat janë disa nga vështirësitë me të cilat përballët QPS Gjakovë. Kjo ka ndikuar që edhe njohuria lidhur me masat aktive të tregut të punës të jetë e kufizuar dhe të ekzistojë nevoja për informata më të shumta. Të dhënat e intervistës do t'i paraqesim me sa vijon.

Numri i përfituesve të asistencës sociale në komunën e Gjakovës, gjegjësisht në QPS Gjakovë, është 1.023 familje, nga të cilët 376 familje i takojnë komuniteteve rome, ashkali dhe egjiptiane. Prej këtij numri 92 familje janë rome, 173 familje ashkali dhe 111 familje egjiptiane.³⁹ Komuna e Gjakovës ka mbi 35% përfitues të këtyre tre komuniteteve.⁴⁰

Bashkëpunimi i QPS-së me Zyrën e punësimit është mjaft i mirë dhe na njoftojnë për mundësitë. Ne i përzgjedhim listat dhe pastaj ata merren me ta. ⁴¹ Meqenëse shumica e përfituesve të komuniteteve i takojnë kategorisë së dytë dhe ne kemi numër të vogël i stafit kjo ka ndikuar që të mos arrijmë t'i trajtojmë ndoshta në mënyrën më të mirë, apo edhe

37. Arbër Zhubi – Këshilltar i punësimit - Zyrtar për Shërbime të punësimit 20 Maj 2019

38. Arbër Zhubi, Këshilltar i punësimit, Zyra e punësimit Gjakovë

39. Baza e të dhënave të asistencës sociale, QPS Gjakovë, 20 maj, Pranush Komani - Udhëheqës i asistencës sociale

40. Pranush Komani - Udhëheqës i shërbimit të asistencës sociale, QPS Gjakovë

41. Pranush Komani - Udhëheqës i shërbimit të asistencës sociale, QPS Gjakovë

të bëjmë verifikime në terren. Kohë pas kohe në QPS Gjakovë paraqiten kompani të cilat kanë kërkuar punëtorë me paga deri në 350 euro dhe kur janë kontaktuar pjesëtarët e komuniteteve, ka pasur reagime të llojit - pse po ftohemi vetëm ne dhe jo të tjerët, dhe e kanë shfrytëzuar këtë si pretekst për refuzim të punës. Edhe pse ka oferta për punë, në kuadër të masave aktive të tregut të punës, QPS Gjakovë nuk ka pasur asnjë rast kur Zyra e punësimit nuk i ka lëshuar vërtetimin e papunësisë dhe që është larguar nga skema e asistencës sociale. Po ashtu QPS është përballur me probleme të mos-vijimit të shkollimit të fëmijëve të komuniteteve, por në asnjë rast nuk ka larguar familje të komuniteteve për shkak të mungesës së vërtetimit të shkollës, sepse mungesa e vërtetimit është arsyetuar me një deklaratë të prindërve për arsyet e mos-vijimit të shkollës dhe për të mos e rënduar më shumë gjendjen e familjeve QPS tenton të gjejë metoda dhe forma për mos-ndërprerje të asistencës sociale.

Në secilin rast, kur një anëtar i një familje aktivizohet në masat aktive të tregut të punës QPS e ndërpret asistencën sociale dhe menjëherë pas ndërprerjes së punës e rikthejmë familjen në skemë.

Edhe përkundër marrëdhënieve të mira me Zyrën e punësimit, ata nuk e informojnë asnjëherë QPS-në për angazhimin e familjeve dhe krejt kjo mund të jetë si pasojë e mungesës së lidhjes së sistemeve dhe këmbimit të informatave mes institucioneve. Edhe kur ka ndonjë komunikim, ai realizohet me gojë dhe jo përmes formës zyrtare të shkruar. Në QPS vërehet mungesa e legjislacionit dhe udhëzimeve administrative, pasi që ata nuk janë të pajisur nga politikë bërësit me dokumente të domosdoshme për punë. QPS nuk ka pasur asnjë fushatë vetëdijesuese, nuk ka asnjë dokument apo broshurë brenda QPS-së e cila bën informimin e palëve për mundësitë e angazhimit në ndonjërin prej MATP-ve. Rekomandohet të rritet bashkëpunimi me zyrat e punësimit, të bëhet njoftimi me kohë për mundësinë e punësimit të kategorisë së dytë dhe të veprohet në bazë të ligjit dhe udhëzimeve administrative që nëse klienti nuk pranon dy herë punësimin të mos e lëshojë vërtetimin e papunësisë dhe të na lehtësojë punën edhe neve, sepse familjet kanë krijuar varësi nga SAS dhe shumë nga ta

dyshohet se punojnë edhe në punësim joformal dhe nuk ka mundësi të identifikohen.⁴²

Qendra e aftësimit profesional - Gjakovë

Qendra e aftësimit profesional në Gjakovë është intervistuar në kuadër të vlerësimit të zbatimit të masave aktive të tregut të punës, bazuar në strategjinë nacionale të MPMS-së. Qendra e aftësimit profesional ka një staf profesional të përgatitur dhe mjaft aktiv në përgatitjen e qytetarëve me trajnimet në dispozicion.

Kurset e ofruara nga Qendra e aftësimit dhe riaftësim profesional për të punësuarit dhe punëkërkuessit, bazuar në sistemet modulare që ofrohen në Qendrën trajnuese në Gjakovë janë:

1. Rrobaqepësi
2. Menaxhimi i ndërmarrjeve mikro dhe të vogla
3. Vetëpunësimi
4. Parukier
5. Grimere
6. Instalues elektrik
7. Saldim
8. Asistent administrativ
9. Kontabilitet

Gjatë vitit 2018, 560 kursantë kanë vijuar trajnimet në Qendrën e aftësimit profesional të cilët edhe e kanë kompletuar kursin e janë certifikuar. Prej tyre 36 kanë qenë nga komunitetet rome, ashkali dhe egjiptiane. Gjatë vitit 2019, deri më tani janë 320 kursantë prej të cilëve shtatë vijnë nga komunitetet.⁴³

Profesionet ku janë kyçur më shumë minoritetet janë floktari dhe rrobaqepës, kurse sa i përket profesioneve tjera sfidues është mungesa e njohurive të shkrim-leximit dhe matematika fillestare për vijim në kurse. "Mirëpo ka pasur raste kur edhe kanë filluar me kurse dhe janë tërhequr, e kanë ndërprerë kursin, për çka ne pa e kompletuar kursin nuk kemi lëshuar certifikatën".⁴⁴

Edhe QAP përballlet me mungesë të kuadrove profesionale për trajnim të punëkërkuessve dhe duhet të kompletohet stafi si dhe të mendohet për profesione të reja për të ardhmen bazuar në nevojat e tregut të punës, të rifreskohen profesionet.

42. Pranush Komani - Udhëheqës i asistencës sociale, 20 maj 2019

43. Shaban Laha - QAP Gjakovë

44. Shaban Laha - QAP Gjakovë

Komuna e Prizrenit

Zyra e punësimit Prizren

Komuna e Prizrenit është një qytet i përbërë nga nacionalitete të ndryshme, ku komunitetet rome, ashkali dhe egjiptiane janë pjesë përbërëse me një proporcion të përafërt ku dominon komuniteti rom.

Komuna e Prizrenit rezervon një kuotë punësimi prej rreth 10 për qind për minoritetet edhe pse komunitetet në përgjithësi tejkalojnë këtë kuotë.

Sa i përket zbatimit të strategjisë nacionale të MPMS-së edhe Prizreni përballet me disa pengesa e vështirësi, e që një nga pengesat më të mëdha apo kryesore e zbatimit të masave aktive është arsimi i ulët tek komunitetet.

Komunitetet rome, ashkali dhe egjiptiane zakonisht u përgjigjen ftesave për trajnime dhe janë në rrjedhë me tregun e punës, ku Zyra e punësimit bën përpjekje që të shkojë me kërkesa paralele me nevojat në tregun e punës, sepse edhe ndryshimet në treg u kanë mundësuar të angazhohen më shumë pas përgatitjes dhe aftësimi.

Angazhimi në trajnim në punë përkrahet me mbështetje financiare prej 150 eurosh në muaj, mirëpo të dhënat e sakta nuk janë të evidentuara në bazën e të dhënave. Karakteristike është se shumë herë punëtorët që Zyra e punësimit i dërgon në biznese të ndryshme shkojnë për të përfituar vetëm për tre muaj, mirëpo pasi ndjekin punën tremujore dhe me ndërmjetësimin tonë, ka shumë raste kur mbesin në punë pasi ata familjarizohen edhe me vendin e punës dhe ndërtojnë raporte me punëdhënësin deri në atë masë sa punëmarrësi i ndalë për periudha afatgjate, çka është edhe qëllimi i ynë.⁴⁵

Zyra e punësimit mban raporte shumë të mirë në terren me disa nga bizneset, mirëpo është

interesante se shumë pak biznese shkojnë tek Zyra e punësimit që të kërkojnë punëtorë. Nga disa takime me ta, ka rezultuar se një nga faktorët e mosbashkëpunimit është se stafi menaxhues i kompanive është i dobët në këtë aspekt dhe nuk e përcjellin shtypin, informimin, broshurat dhe fushatat e organizuara nga Zyra e punësimit dhe partnerët tanë. Por, duhet theksuar se ka edhe mungesë të punës profesionale në Zyrën e punësimit në gjithëpërfshirje dhe zgjerim për nxitjen e bizneseve në lajmërim për t'i informuar për mundësitë e bashkëpunimit.

Komuna e Prizrenit njihet si një qytet i zanateve dhe mungesa e punëtorëve profesional është shumë madhe në Prizren. "Kam pasur rastin që një kompani të më kërkojë përnjëherë gjashtë zdrukthëtarë, ndihmës-zdrukthëtarë dhe dy mirëmbajtës dhe m'i ka dhënë afat dy javë t'i gjejë dhe ne nuk mundemi t'i gjejmë pikërisht sepse s'ka profesionistë të kësaj fushe të regjistruar në Zyrën e punësimit".⁴⁶

Pas bisedave dhe analizave të Zyrës së punësimit në Prizren rezulton se secila kompani në Prizren që merret me zanat është në gjendje të pranojë minimum nga një punëtor me profesion/zanat, mirëpo Zyra e punësimit nuk ka të tillë në dispozicion.

Prizreni ka mbi 15.000 biznese të regjistruara, prej të cilave në Zyrën e punësimit në vitin 2018 janë lajmëruar vetëm rreth 300 biznese për të kërkuar punëtorë.

Zyra e punësimit në Prizren në bashkëpunim me organizata joqeveritare ka organizuar takime vite më parë, ku kanë qenë mbi 30 biznese të mëdha. Debati ka qenë i bazuar në dy pika, ku ankesa thelbësore e bizneseve ishte se nuk po gjejnë

45. Hasil Fetahu – Këshilltar i punësimit, 15 maj 2019

46. Hasil Fetahu – Këshilltar i punësimit, Zyra e punësimit në Prizren
Hasil Fetahu – Këshilltar i punësimit, Zyra e punësimit në Prizren

punëtorë profesionist por edhe me përgatitje të mesme, përderisa në anën tjetër ankesat e punëtorëve ishin se kompanitë nuk po e respektojnë orarin e punës, ku punëtorët punojnë më orar të stërzgatur, punojnë vikendeve, nuk respektohet pushimi vjetor, pushimi i lehonisë, nuk ka siguri në punë, e që janë disa nga faktorët e mosshfaqjes së interesimit për angazhim në kompanitë e tyre.

Si Zyre e punësimit nuk kemi pasur asnjëherë rast t'ua ndalojmë vërtetimin e papunësisë për përfitim të ndihmës sociale dhe kjo nuk është e mirë nga ana jonë.⁴⁷

QPS nuk bashkëpunon me Zyrën e punësimit e që është një e metë e madhe. Sistemi Administratës Tatimore të Kosovës (ATK) po ashtu shumë shpesh është jofunksional. Në fillim ka punuar për një periudhë disamujore dhe është ndërprerë dhe tani mungon edhe ky komunikim.

Ky mosbashkëpunim me Qendrën për punë sociale ndikon shumë keq, sepse edhe në rastet kur ne kërkojmë nga ta ndonjë ndihmë, ata nuk na ofrojnë ndihmë në identifikim e punëtorëve nga kategoria e dytë, dhe një pengesë e tillë ndikon drejtpërdrejt edhe në zbatimin e strategjisë nacionale të MPMS rreth masave aktive të tregut të punës.

Komunitetet nuk kanë asnjë problem në gjuhën e folur, por bizneset shpesh edhe zgjedhin dhe nuk shprehin interesim të punësojnë pjesëtarë të komuniteteve rome, ashkali dhe egjiptiane, sidomos për disa punë ku duhet të shfaqen para klientëve të tyre dhe të kenë kontakt të drejtpërdrejtë, qoftë në arka ku bëhet pagesa apo recepcion. Si Zyre e punësimit ne organizojmë fushata vetëdijesuese, por kemi edhe bashkëpunim me partnerë. Një nga to është edhe një OJQ lokale "Romani Avazo" ku bëhen shpalljet dhe njoftimet përmes zërit të radios dhe atë në disa gjuhë, sidomos në gjuhën rome.

Me Zyrën për komunitete dhe kthim bashkëpunimi është shumë i mirë, dhe ata vijnë shumë shpesh tek ne për të kërkuar informata, por edhe dërgojnë informata kur ne kemi nevojë.

Vitet e fundit ka ndryshime të mëdha dhe shumë pak ka dallime. Komunitetet janë integruar dhe ne i kemi pranuar dhe nuk shpërfaqet asnjë dallim mes nesh, përderisa problematika e punës mbetet e njëjtë fatkeqësisht.

Sa u përket standardeve minimale të zhvilluara vite më parë, ato vetëm se zbatohen vetvetiu, sepse nuk ka ndonjë mjet për matjen e tyre në terren se në çfarë përqindje janë përmbushur, ose jo.



47. Hasil Fetahu – Këshilltar i punësimit, Zyra e punësimit në Prizren

Qendra për punë sociale - Prizren

Qendra për Punë Sociale në Prizren funksionon në kuadër të kompetencave komunale e cila është përgjegjëse për ofrim dhe trajtim të rasteve sociale dhe qytetarëve në gjendje të nevojës sociale. Mirëpo, QPS Prizren nuk ka shumë njohuri dhe informacione sa i përket masave aktive të tregut të punës.

Numri i përfituesve të asistencës sociale është 891, prej të cilit nga komunitetet rome, ashkali dhe egjiptiane janë 126 familje, respektivisht 88 familje rome, 28 familje ashkali dhe 10 familje egjiptiane.⁴⁸

Për dallim nga komunat tjera, QPS-së në Prizren nuk i paraqet aspak problem ri-aplikimi i këtyre familjeve të cilat kryesisht i takojnë kategorisë së dytë të asistencës sociale dhe të cilat duhet të paraqiten në QPS çdo gjashtë muaj, sepse në këtë formë ata konsiderojnë se e kanë më shumë situatën nën kontroll, ani pse për çdo ri-aplikim këto familje duhet të rifreskojnë të gjitha dokumentet e parapara sipas Ligjit të skemës së asistencës sociale.

Problemet më të mëdha gjatë fazës së ri-aplikimit, por edhe gjatë gjithë procesit të ri-aplikimit tek komunitetet rome, ashkali dhe egjiptiane shfaqen tek certifikata e shkollës përmes së cilës duhet të dëshmohet se fëmijët deri në moshën 18-vjeçare ndjekin shkollimin, sepse mos-vijimi i mësimit nënkupton automatikisht edhe ndërprerje të asistencës sociale. Zyrtarët e asistencës sociale në

raste më të rënda mundohen të bëjnë përjashtime, me qëllim të ngritjes së vetëdijes se ata duhet të vijojnë mësimin, por ka edhe disa raste kur u është ndërprerë dhënia e ndihmës sociale për këtë arsye. Gjatë këtyre viteve QPS Prizren nuk ka pasur asnjë rast përjashtimi të familjes në mungesë të pajisjes me vërtetim të papunësisë nga ana e Zyrës së punësimit, e që rezulton me një zbrazësi rreth zbatimit të masave aktive të tregut të punës.

Nuk ka ndonjë fletushkë informative brenda QPS-së lidhur me mundësinë e punësimit dhe llojin e masave aktive që janë në dispozicion. Mungesa e informatave dhe fushatave vjen edhe si pasojë e mosbashkëpunimit mes QPS Prizren dhe Zyrës së punësimit në Prizren, për çka konfirmojnë të dy palët se nuk kanë ndonjë komunikim të mirëfilltë dhe kërkohet të punohet më shumë në këtë drejtim.

Gjithashtu zyrtarët e asistencës sociale nuk janë shprehur të kënaqur edhe nga premtimi dhe fushata e realizuar nga Qeveria e Kosovës, ku janë grumbulluar familjet me asistencë sociale dhe u është premtuar publikisht se secila familje do ta ketë nga një të punësuar, e që do të ishte një ndihmë e madhe si për ta ashtu edhe për skemën sociale, e që deri më sot nuk ka pasur asnjë lëvizje pozitive në këtë drejtim. Krejt ky premtim ka qenë në kuadër të realizimit të strategjisë nacionale për zbatimin masave aktive të tregut të punës.



48. Hamit Krasniqi - Zyrtar i asistencës sociale. Baza e të dhënave të asistencës sociale, QPS Prizren, 16 maj

Qendra për punë sociale - Prizren

Qendra e aftësimit profesional në Prizren është qendër rajonale ku bëhet përgatitja për personat në nevojë për trajnime profesionale si pjesë e strategjisë nacionale të MPMS-së. Trajnimet që mbahen në këtë qendër janë të lidhura drejtpërdrejt me masat aktive të tregut të punës.

Kurset që ofrohen në këtë qendër trajnimi janë:

1. Administrim biznesi
2. Auto-elektrikë
3. Auto-mekanikë
4. Banakier
5. Kamerier
6. Kuzhinier
7. Mekanika e hidraulikës dhe pneumatikës
8. Elektromekanika e pajisjeve të amvisërisë
9. Parukier
10. Grimere
11. Elektronikë industriale
12. TIK
13. Rrobaqepësi
14. Furrтари
15. Saldim
16. Vetëpunësim

Gjatë vitit 2018 për trajnim profesional brenda QAP kanë qenë gjithsejtë 1.608 persona, nga ta 19 romë, 3 ashkali, asnjë egjiptian, 44 turq, 48 boshnjakë, 11 serbë dhe 1.483 shqiptarë.⁴⁹ Bashkëpunimi me Zyrën e punësimit është primar dhe funksionon shumë mirë, përderisa me institucionet tjera bashkëpunimi është jo i ndonjë niveli të kënaqshëm. Ligji e parasheh edhe ashtu këtë formë të bashkëpunimit, në mënyrë që palët mundë të vijnë në Qendër të aftësimit profesional vetëm përmes Zyrës së punësimit, pa marrë parasysh llojin dhe kategorinë që i përkasin. Sfidat të mëdha për QAP sa i përket komuniteteve janë shkollimi, shkrim-leximi, apo edhe moshja jo adekuate ku shumë herë QAP detyrohet të dalë jashtë kriterëve për hir të mirëkuptimit dhe inkuorporimit në shoqëri të këtyre tre komuniteteve.

Qendra e aftësimit profesional është në gjendje stabile me trajnime. Kapaciteti trajnues i QAP-it është 1.200 kandidatë të trajnuar, por mund të përballohen edhe deri në 1.500 brenda vitit.⁵⁰ Për disa profesione ka më shumë kërkesa si p.sh. parukeri, grimere, kuzhinier, saldues, furrtar dhe

rrobaqepës. Më së paku kërkesa ka për elektromekanikë për pajisje të amvisërisë dhe mekanikë e hidraulikës, edhe pse tregu ka kërkesa të mëdha për këto dy profesione.

Bashkëpunimi me bizneset më shumë lidhet përmes Zyrës së punësimit dhe nevojat e tyre i identifikojnë nga MPMS-ja, përderisa trajnimin e kombinuar, mbrojtjen dhe sigurinë e kryejnë tek ne. Shpesh i dërgojmë ta kryejnë praktikën në kompani, atëherë kur ka mundësi, kurse pjesën teorike e kryejnë në QAP. Pra, kjo ndodhë në raste kur gjejmë mirëkuptim me kompani të specializuara dhe bëhet një kombinim i vlerave që është në interes të përfituesve. Me programet e reja ne po bëjmë përpjekje të jemi në trend edhe sa i përket mësimi dual, pra në dy drejtime përnjëherë - në dy profesione/zanate të ndryshme, pasi që kjo tanimë ka kaluar në një trend bashkëkohor.⁵¹

Popullata e Prizrenit merret dhe mbijeton kryesisht me zanate dhe personat e punësuar në sektor publik dhe administratë përveç punës së tyre primare, pjesën tjetër e kalojnë në zanate e që ndihmon shumë në zbatimin e masave aktive të punës.

Komunitetet rome, ashkali dhe egjiptiane i përcjellin trajnimet deri në fund dhe nuk ka ndodhur të kemi raste që e kanë ndërprerë trajnimin e tyre profesional në QAP.

Ka shumë raste kur pjesëtarët e komuniteteve angazhohen edhe në profesione si kamerier e kuzhinier, edhe pse mundësia e punësimit të tyre duket të jetë më e vogël.

Sa i përket zbatimit të strategjisë nacionale, nuk mund të themi se po zbatohet në plotëni, sepse shumë pjesëtarë të komuniteteve rome, ashkali dhe egjiptiane kanë përshtypjen se nëse angazhohen në ndonjë punë, me automatizëm do t'u ndalet ndihma sociale dhe pastaj do ta kenë të vështirë të rikthehen në sistem, gjë që po ndikon shumë negativisht. Krijimi i varësisë shumëvjeçare nga asistenca sociale vazhdon të ndikojë drejtpërdrejt në zbatimin masave. Certifikatat e lëshuara nga Qendra e aftësimit profesional janë certifikata të cilat njihen si brenda ashtu edhe jashtë vendit.

49. Sinan Gashi - Qendra e aftësimit profesional, Prizren

50. Sinan Gashi - Qendra e aftësimit profesional, Prizren

51. Sinan Gashi - Qendra e aftësimit profesional, Prizren

Qendra për punë sociale - Prizren

Në kuadër të Komunës së Prizrenit funksionon edhe Zyra për komunitete dhe kthim, e cila ka të punësuar një staf të përzier me nacionalitete të ndryshme si dhe ofron shërbime për gjithë qytetarët e riatdhesuar brenda komunës së Prizrenit. Për më tepër, angazhimi i ZKK dhe bashkëpunimi me OJQ të ndryshme brenda komunës, por edhe OJQ të cilat funksionojnë në nivel nacional, ka arritur që të zhvillojë disa dokumente të rëndësishme dhe të jetë pjesë e shumë trajnimeve në ngritjen kapaciteteve profesionale por edhe në hartim të politikave lokale.

Komuna e Prizrenit e ka të zhvilluar Planin lokal të veprimit për përfshirjen e komuniteteve rome, ashkali dhe egjiptiane të komunës së Prizrenit 2019-2023.

Ky plan përfshin pesë fusha: Arsimi, punësimi dhe mirëqenia sociale, shëndetësia, banimi dhe kultura, mediat dhe informimi. Për zbatimin e këtij plani pesëvjeçar janë paraparë gjithsejtë 1.276,750 euro, prej të cilave 995.005 euro parashihen të mbulohen nga buxheti komunal dhe 281.745 nga donatorët.⁵²

Tek pjesa e punësimit janë identifikuar tre sfida: 1. Niveli shumë i lartë i papunësisë, 2. Zyra e punësimit nuk e ka mandatin për punësim, prandaj mund mos ta ketë si prioritet, dhe 3. Buxheti kufizuar për shërbimet sociale si shkak i kërkesave të shumta⁵³. Ky plan po ashtu ka paraparë disa aktivitete si: Analiza e gjendjes së të punësuarve të komuniteteve rome, ashkali dhe egjiptiane në institucionet publike, fushatë vetëdijësuese për rëndësinë e Zyrës për punë dhe shërbimet që ofron ajo, përkrahje për hapjen e bizneseve të reja, ofrim i trajnimeve profesionale, start-up biznese për komunitetet rome, ashkali dhe egjiptiane, fushatë avokuese për respektimin e kuotës së punësimit në institucionet publike si dhe fushatë vetëdijësuese për skemat sociale dhe format e shfrytëzimit të tyre.

Numri i të riatdhesuarve gjatë vitit 2018 është gjithsejtë 22 familje me 55 anëtar prej tyre 7 familje të komuniteteve rome, ashkali dhe egjiptiane me 33 anëtarë.⁵⁴

Si të vetëpunësuar nga plani i biznesit kanë përfituar 17 familje deri më 2018 nga masat aktive të tregut të punës të përkrahur nga GIZ, ku kanë përfituar vetëm mjete dhe me herët kanë qenë rreth 40

familje të cilat kanë përfituar mjete financiare, por që u janë ndërprerë.

Fushata e riatdhesimit ka ndikuar shumë tek komunitetet që ata të mos migrojnë pa letra sepse e shohin se cilat janë vështirësitë. Në anën tjetër, bizneset nuk ofrojnë kushtet elementare për punë si siguria, e shohim ndërtimtarinë ku nuk kalon muaj pa ndonjë të vdekur e shumë të lënduar në vend pune.

Bashkëpunimin i ZKK-së me Zyrën e punësimit dhe Qendrën për punë është shumë i mirë.

Zyra e punësimit kërkon punëtorë dhe i aftëson ata. Palët tona i kemi përcjellë për në Qendrën e aftësimit profesional dhe ata bashkëpunojmë me ne në vazhdimësi. Personat të cilët i plotësojnë kriteret i dërgojmë në Qendrën aftësimit profesional për trajnim dhe certifikim. Bëhet përjashtim tek kriteret për komunitete, sidomos kur është në pyetje përgatitja shkollore dhe moshë.

Ndryshimet e fundit tek planet e biznesit dhe financimi i tyre ZKK-në e kanë liruar shumë nga disa obligime dhe tani ZKK ndihet më komode pasi që gjitha financimet kanë kaluar në MPMS dhe Zyrat e punësimit, ku familjeve po u jepen mjete pune dhe jo mjete materiale, që ka ndikuar në uljen e keqpërdorimit të mjeteve materiale dhe familjet që kanë përfituar mjete pune po arrijnë të punojnë me to.

Duhet të theksohet se brenda komunës së Prizrenit kanë qenë të punësuar pesë persona të komuniteteve rome, ashkali dhe egjiptiane, por dy nga ta janë larguar - njëri në pension dhe tjetri për arsye tjera, dhe asnjëherë nuk janë zëvendësuar nga komunitetet, e që tani janë vetëm tre të punësuar nga këto komunitete.⁵⁵

Gjuha nuk paraqet asnjë problem në komunikim dhe në punësim dhe kërkesa e ZKK-së ka qenë dhe mbetet që edhe gjuha rome të futet në përdorim zyrtar dhe të njihet si gjuhë tradicionale. Rreth 95% e fëmijëve të komuniteteve rome, ashkali dhe egjiptiane e vijnë në mësimin, që është mirë, edhe pse kohë pas kohe ka braktisje të shkollës.

52. Planin lokal i veprimit për përfshirjen e komuniteteve rome, ashkali dhe egjiptiane në Komunën e Prizrenit, 2019-2023

53. Planin lokal i veprimit për përfshirjen e komuniteteve rome, ashkali dhe egjiptiane në Komunën e Prizrenit, 2019-2023

54. Islam Elshani - Zyrtar për komunitete dhe kthim, Komuna e Prizrenit

55. Islam Elshani - Zyrtar për komunitete dhe kthim, Komuna e Prizrenit

OJQ-ja lokale “Romani Avazo”

“Romani Avazo” është organizatë joqeveritare lokale dhe ka një bashkëpunim shumë të mirë me Zyrën e punësimit në Prizren. Kjo organizatë ushtron disa aktivitete të ndryshme, duke trajnuar persona të rinj dhe të interesuar për gazetari, teknikë dhe montazh, si dhe punë terreni. Në secilën shpallje nga Zyra e punësimit organizata aplikon për ofrim të trajnimeve por edhe grante dhe subvencione në kuadër të masave aktive të tregut të punës për aftësim dhe angazhim të pjesëtarëve të komuniteteve rome, ashkali apo egjiptiane. Gjatë secilit vit, kjo organizatë ka angazhuar një apo dy persona për trajnim dhe aftësim dhe disa nga ta kanë mbetur të punësuar të përhershëm.

Organizata varet nga donacionet pasi që ende nuk ka kaluar në biznes përderisa planet janë që të kalojë në ndërmarrje sociale.

Punëtorët e angazhuar në OJQ “Romano Avazi” përfitojnë nga 150 euro subvencion nga MPMS-ja dhe gjatë kësaj periudhe organizata vetëm ngrit kapacitetet e tyre.

Mirëpo, është shumë me rëndësi të theksohet se në kuadër të organizatës funksion një radio lokale e quajtur “Radio Romani” dhe përmes emisioneve të llojllojshme me mysafirë të ndryshëm, sidomos në pjesën e punësimit dhe mundësive tjera, organizojnë debate dhe thërrasin mysafirë të cilët promovojnë vendet e punës, njoftojnë për mundësitë dhe krejt kjo bëhet në dy gjuhë - shqipe dhe atë rome.⁵⁶

Aktivitetet e organizatës janë edhe të natyrës praktike, prej takimeve të drejtpërdrejta në lagjet ku janë më të banuara me komunitetin rom dhe përpjekja për ndërlidhjen e tyre ka rezultuar e suksesshme.

Mirëpo, edhe kjo organizatë ka pakënaqësitë e saja sa i përket ndarjes së subvencioneve dhe përkrahjes nga Zyra e punësimit, sepse e konsideron se përkrahja nuk është e mjaftueshme dhe shpesh

përfitojnë disa organizata të komuniteteve të cilat nuk paraqesin ndonjë rezultat të mirë, apo edhe abuzohet me mjetet, ose edhe me orar të stërzgatur dhe asnjë ndihmë shtesë nga kompanitë që i angazhojnë ata punëtorë, pa i shtuar asnjë përkrahje nga vet ata, ku e vetmja shumë është 150 euro nga subvencioni i MPMS-së.

Përveç njoftimeve përmes radios, organizata ka zhvilluar edhe një faqe interneti si dhe faqen e saj në rrjetin Facebook ku në baza të rregullta paraqet njoftimet dhe ndryshimet e reja, si dhe njofton për takimet ku komunitetet mund të njoftohen.

OJQ “Romani Avazo” ka edhe një hapësirë shumë të përshtatshme pune ku pjesëtarët e komuniteteve e shfrytëzojnë dhe ndihmohen nga stafi i organizatës që të shkruajnë plane biznesi, të plotësojnë aplikacione, shkruajnë CV-të e tyre, etj. për t’u punësuar apo përfituar grante. Si tregim suksesi janë dy familje të riatdhesuara të cilat kanë përfituar pikërisht nga përkrahja e OJQ-së “Romani Avazo”.

Asnjë nga televizionet lokale nuk ka minutazh për komunitete, prandaj funksionimi i këtij radio stacioni është shumë me rëndësi.

“Për çdo ndryshim në legjislacion dhe rregullore apo plan strategjik ne e informojmë qytetarët duke ftuar mysafirë në radio, personalitetet të ndryshme, ku kemi pasur të përfshirë kryetarin e komunës, drejtorin e punës dhe mirëqenies sociale dhe zyrtarë tjerë me rëndësi”.⁵⁷ Organizata në vazhdimësi aplikon në thirrjet e ndryshme për përkrahje pasi që varet nga donacionet.

Është me rëndësi të përmendet se trajnimet nuk janë edhe shumë të bazuara në nevojat e qytetarëve, sidomos në fusha specifike si ujësjellës e kanalizim e ngrohje qendrore, edhe pse aty ka shumë kërkesa dhe shumë lehtë gjendet puna. Duhet të bëhen ndryshime në programet trajnuese, pasi që disa programe janë të vjetra dhe vështirë gjen punësim pas certifikimit në QAP.

56. Romano Abazi – intervistë, 15 maj 2019

57. Romano Abazi – intervistë, 15 maj 2019

Rekomandime:

- Të përpilohet broshura informuese për masat aktive të tregut të punës dhe të njëjtat të shpërndahen në Qendra për punë sociale aty ku aplikojnë për ndihmë sociale, në Shtëpi të Shëndetit - aty ku marrin shërbime shëndetësore, në Zyrat për komunitet dhe kthim, në Agjencinë civile dhe Zyrat për pajisje me dokumentacion, njoftime përmes mediumeve, si dhe në takime të drejtpërdrejta me komunitete, etj.
- Broshurat të shpërndahen në lokale të ndryshme afariste ku frekuentojnë më shumë komunitetet nëpër komuna
- Ngritja e bashkëpunimit mes Zyrës së punësimit dhe Qendrës për punë sociale në komunën e Prizrenit, pasi që mungon një bashkëpunim i domosdoshëm mes tyre, ashtu siç ndodh në komunat tjera
- Trajnime dhe ngritje të kapaciteteve për këshilltarët e punësimit në Zyrat e punësimit aty ku marrin vërtetimin e papunësisë për ndihmë sociale dhe lajmërohen për punë, apo refuzojnë punën
- Të përgatitet një listë për gjithë ata që e marrin informatorin dhe të nënshkruhen, me qëllim të vlerësimit në të ardhmen se sa janë paraqitur dhe sa ka qenë i dobishëm informatori
- Të ndërlihen sistemet e bazave të dhënave në mes të Qendrës së aftësimi profesional, Zyrës së punësimit, Qendrës për punë sociale dhe Administratës Tatimore të Kosovës, përmes të cilave do të koordinoheshin dhe këmbëheshin informatat dhe do të zhvilloheshin aktivitete të përbashkëta
- Fushata mediale rreth sensibilizimit të punëkërkuesve dhe punëdhënësve, sepse angazhimi i madh gjatë ditës shpesh nuk ofron kushte për një informim të mirëfilltë të tyre, apo edhe mungesë përqendrimi në pranimin e informatave
- Fushata vetëdijësuese me bizneset dhe popullatën për pranimin e komuniteteve në pozita ku kanë qasje të drejtpërdrejtë me klientë dhe mosdiskriminim
- Të ngritën kapacitetet profesionale në Zyrat për kthim dhe komunitete dhe të forcohet bashkëpunimi me akterët komunal e qendror
- Të largohet kriteri diskriminues për të punësuarit fillestar, kriteri prej dy apo tre vitesh përvojë pune pas studimeve, sepse është barrierë e madhe edhe për komunitetet dhe për të tjerët në inkuadrimin në punë
- Mungesa e kuadrove profesionale për trajnime të avancuara dhe të bazuara në kërkesat e tregut të punës si dhe përshtatja e profesioneve bazuar në kapacitetet e komuniteteve rome, ashkali dhe egjiptiane në Qendrat e aftësimi profesional
- Mungesa e praktikës në punë dhe refuzimi i disa kompanive për marrjen në punë, sidomos në vende të dukshme siç është puna në arka apo reception për pjesëtarët e komuniteteve
- Orientimi i drejtë për profesionet, të bazuara në kërkesat e tregut, si dhe puna me pjesëtarët e komuniteteve për pranimin dhe angazhimin në punë të ndryshme
- Të plotësohen vendet e lira të punës në komunat ku janë larguar apo pensionuar pjesëtarët e komuniteteve, siç është rasti me Komunën e Prizrenit
- Të vendoset gjuha rome si gjuhë zyrtare për përdorim në Komunën e Prizrenit si dhe bashkëpunim më i ngushtë me Ministrinë Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë në aftësimin e personave të komuniteteve në mësimnxënie si një nga barrierat e para drejt aftësimi
- Të inkurajohen fëmijët e komuniteteve në vijimin e shkollimit dhe mos të pranohen arsyetimet e prindërve për pamundësi të ndjekjes së shkollës, duke i angazhuar fëmijët në punë të ndryshme dhe të rënda
- Qendrat për punë sociale të punojnë më shumë përmes shërbimeve të tyre në bindjen dhe stimulimin e komuniteteve për vijimin e shkollimit si dhe të ndërmarrin masat në rastet e përfutimit të asistencës sociale që secila familje t'i sjellë vërtetimet e vijueshmërisë së shkollimit, në bashkëpunim të ngushtë me drejtorët e

shkollave dhe drejtoritë komunale të arsimit

- Të punohet më shumë drejt largimit nga varësia e krijuar nga ndihmat sociale dhe pakot e ndryshme, të cilat vazhdojnë të konsiderohen si të ardhura të sigurta edhe pse shumë të ulëta për familjet e komuniteteve
- Meqenëse certifikatat e QAP janë të pranura si brenda vendit ashtu edhe jashtë vendit, gjithë ata që planifikojnë të lëshojnë Kosovën duhet të ndjekin kurset dhe pajisen me certifikata në mënyrë që të kenë një profesion dhe të gjejnë punë më lehtë edhe me rastin e emigrimit
- Të sensibilizohet opinioni lidhur me arsimin dual profesional, krahas studimit edhe orientimi për aftësim profesional në ndonjërin nga drejtimet në dispozicion për komunitetet
- Të rritet koordinimi mes shkollave profesionale dhe identifikimi i kërkesave të tregut, përmes mundësisë së ndërrimit të profesionit dhe drejtimit, duke ju përshtatur tregut të punës
- Të ndahen mjete nga taksat edhe për shkollat private dhe shkollat profesionale private për financim dhe ofrim të trajnimeve profesionale për aftësim në punë të komuniteteve
- Të sigurohet qëndrueshmëria në punë për pjesëtarët e komuniteteve, pasi që shpesh ka raste që brenda ditëve apo javëve e braktisin vendin e punës
- Të krijohen vende pune karshi përgatitjes së tyre, sepse shumica janë të paarsimuar dhe punë të tilla do të kishin punuar dhe mundësisht brenda komunës së Obiliqit
- Pajisja e zyrtarëve në të gjitha institucionet publike me legjislacion përkatës, pasi që shumë nga ta nuk posedojnë ligjet dhe udhëzimet administrative në fuqi
- Të zgjatet mandati për familjet e riatdhesuara sepse nuk po mundën me u kyç në masat aktive të tregut të punës dhe derisa po e marrin veten apo adaptohen në mjedis. Kërkojmë që ky afat të zgjatet së paku në dy vite.

Aneks

THIRRJE PËR APLIKIM PROGRAMI PËR SUBVENCIONIMIN E PAGËS

Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës (APRK) dhe Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) në bashkëpunim me Programin për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (UNDP), shpallë thirrje të hapur për aplikim për mbështetje nga programi për Subvencionimin e Pagës (SP) për ndërmarrjet (punëdhënësit) e interesuar nga sektori privat dhe për punëkërkuessit në 18 komuna të Kosovës: Prizren, Pejë, Gjiilan, Gjakovë, Ferizaj, Suharekë, Rahovec, Dragash, Istog, Klinë, Kamenicë, Viti, Deçan, Malishevë, Junik, Kaçanik, Shtime dhe Shtërpçë.

Rreth Programit për Subvencionimin e Pagës
Qëllimi i programit për Subvencionimin e Pagës (SP) është të krijojë mundësi punësimi për punëkërkuessit në Kosovë duke subvencionuar punëdhënësit të cilët janë të gatshëm t'i punësojnë ata në periudha afatgjata. Kjo është një mundësi unike për të mbështetur rritjen graduale të ndërmarrjeve të Kosovës. Për të përfituar nga programi për SP, punëdhënësi duhet të nënshkruajë një kontratë punësimi 12 mujore me punëkërkuessin në përputhje me legjislacionin në fuqi. Gjatë kësaj periudhe, punëdhënësi do të përfitojë subvencionim nëntëmujor në shumë prej 50% të pagës mujore bruto të punonjësit, me të cilin rast shuma e këtij subvencioni nuk mund të jetë më e lartë se 150.00 euro në muaj. ZP do të mbështesin ndërmarrjet në identifikimin e kandidatëve më të mirë të regjistruar si punëkërkuess sipas nevojave specifike të punëdhënësit.

Përveç mbështetjes së ndërmarrjeve duke subvencionuar punësimin, programi SP ndihmon të gjithë procesin e rekrutimit për vendet e lira të reja. Duke pasur parasysh vështirësitë që ndërmarrjet private hasin në identifikimin dhe angazhimin e stafit të kualifikuar të nevojshëm për të zgjeruar aktivitetet e tyre të biznesit, programi për SP do të përdorë ekspertizën e ZP për të përshtatur çdo vend të lirë të punës me punëkërkuessit e duhur në

përputhje me kriteret e përcaktuara nga ndërmarrjet.

Programi për SP zbatohet sipas hapave në vijim
Hapi i parë - Shprehja e interesimit për të përfituar nga programi për SP:

Të gjitha ndërmarrjet e interesuara të sektorit privat mund të shprehin interesim për të përfituar duke shkarkuar formularin për aplikim nga interneti në adresën: www.aprk.rks-gov.net ose www.mpms.rks-gov.net. Përveç kësaj, formularët për aplikim janë gjithashtu të disponueshëm në ZP në të gjitha komunat. Formularit për aplikim duhet t'i bashkëngjiten certifikatat e regjistrimit të biznesit dhe të numrit fiskal të ndërmarrjes që aplikon.

Hapi i dytë - Zgjedhja e punonjësit dhe nënshkrimi i marrëveshjes:

Këshilltari për punësim do të sigurojë një listë të kandidatëve potencial sipas nevojave të ndërmarrjes. Ndërmarrja zgjedhë kandidatët më të mirë nga lista dhe nënshkruan një marrëveshje me punonjësit për të paktën 12 muaj, kurse subvencionimi i pagës do të jetë në kohëzgjatje prej nëntë muaj brenda marrëveshjes 12 mujore. Pagesat do të realizohen në tremujorin e parë, tremujorin e dytë dhe në tremujorin e katërt. Tremujori i tretë mbulohet nga punëdhënësi.

Kush mund të aplikojë?

1. Ndërmarrjet private

Për pjesëmarrje në program, mund të aplikojnë të gjitha ndërmarrjet (punëdhënësit) e interesuar, të regjistruar në ZP. Ndërmarrjet duhet të jenë të regjistruara në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës (ARBK) dhe të jenë taksapagues aktiv në Administratën Tatimore të Kosovës (ATK).

Bizneset që veprojnë në të gjitha llojet e aktiviteteve ekonomike kanë të drejtë të aplikojnë për programin SP. Prioritet do t'i jepet gjashtë sektorëve prioritarë

ekonomik si në vijim (përzgjedhur nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MTI) pasi që kanë potencial më të lartë për rritje ekonomike në Kosovë), përkatësisht:

- përpunimi i ushqimit dhe industria e paketimit;
- TIK së bashku me kontraktimin e procesit të biznesit dhe sektorin e qendrave për mbështetjen e klientëve;
- industria e përpunimit të metaleve;
- industria e tekstitit;
- turizmi;
- industria e përpunimit të drurit.

Formulari i aplikimit mund të gjendet në internet, në adresat elektronike: www.aprk.rks-gov.net ose www.mpms.rks-gov.net si dhe në ZP në secilën komunë.

2. Punëkërkuessit e papunë

Të gjithë punëkërkuessit e regjistruar në ZP mund të përfitojnë nga programi për SP. Gjatë procesit të përzgjedhjes prioritet do t'u jepet të papunëve afatgjatë (të papunë për më shumë se 12 muaj), me një fokus te:

- gratë,
- pakicat etnike,
- personat me aftësi të kufizuara,
- prindërit vetushqyes.

Të gjithë të interesuarit duhet të regjistrohen në ZP në komunat e tyre përkatëse. Ata që posedojnë certifikata të trajnimit profesional të ofruara nga MPMS ose që kanë marrë pjesë më parë në trajnime në punë, do të kenë përparësi në procesin e përzgjedhjes.

Rastet e konfliktit të interesave me palët e përfshira dhe vendimmarrësit e programit për SP nuk kanë të drejtë të përfitojnë nga ky program.

Punëkërkuessit që kanë përfituar më herët nga ky program, nuk kanë të drejtë aplikimi.

Afati i aplikimit 14 - 24 Maj 2019

Mbështetja financiare për ndërmarrjet

Programi për SP do të sigurojë për punëdhënësin subvencion prej 50% të pagës bruto për çdo person

të papunë të porsa punësuar shuma e së cilës nuk mund të jetë më e lartë se 150.00 euro në muaj. Kohëzgjatja e subvencionit për të gjithë punëkërkuessit e rregullt, klientë të regjistruar në ZP është nëntë muaj nga gjithsej 12 muaj të kohëzgjatjes të kontratës së tyre. Për tre muajt e mbetur, i takon ndërmarrjes paga e plotë e punëtorit.

Si të aplikoni?

• Ndërmarrjet e interesuara private duhet që formularin e aplikimit të plotësuar ta dorëzojnë personalisht ose përmes e-mailit në ZP në komunën e tyre. Formulari i aplikimit është i disponueshëm në internet në adresat elektronike: www.aprk.rks-gov.net ose www.mpms.rks-gov.net, si dhe i shtypur në secilën ZP në tërë Kosovën. Aplikuesit duhet bashkangjitur në aplikacion certifikatat e tyre për regjistrimin e biznesit dhe të numrit fiskal. Ndërmarrjet do të kontaktohen nga ZP me një listë të kandidatëve potencial.

• Punëkërkuessit interesuar për vendet e lira duhet të regjistrohen në ZP në komunat e tyre ose të vizitojnë ZP ku ata tashmë janë regjistruar dhe të informojnë këshilltarët e tyre të punësimit në lidhje me interesin e tyre.

Informacione tjera

Për më shumë informata ju lutemi kontaktoni ZP në komunën tuaj.

Në rast se keni pyetje në lidhje me programin SP, ju lutem kontaktoni projektin ALMP2 në adresën elektronike: almp.ks@undp.org.

Rreth projektit ALMP2 në UNDP Kosovë

Objektivi kryesor i Programeve Aktive të Tregut të Punës (PATP/ALMP) është përmirësimi i kapaciteteve të institucioneve të tregut të punës për të hartuar politikat relevante të përgjegjshme-gjinore në nivelin qendror dhe ofrimi i shërbimeve të integruara në nivel lokal duke u fokusuar në grupet më të cënueshme në mesin e të papunëve. Gjithashtu, projekti ofron mundësi për punësim dhe trajnim për personat e papunë të regjistruar në ZP në të gjithë Kosovën përmes programeve të ndryshme aktive si: Subvencionimi i Pagave (SP), Trajnim në Punë (TP), Praktikë në Punë (PP) dhe Vetëpunësim (VP).



ROMA INTEGRATION 2020
Regional Cooperation Council